

GJYKATA THEMELORE E GJILAN/GNJILANE
PKR. Nr. 53/13
16 tetor 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E GJILAN/GNJILANE, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe gjyqtarja kosovare Emine Salihu, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga zyrtari ligjor Tobias Lapke si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të pandehurve:

- 1. V.J., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me akuzën 2, ORGANIZIM I NJË GRUPI TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (1) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (1) i KPRK-së, dhe akuzën 3, KONTROLL DHE POSEDIM I PAAUTORIZUAR I ARMËVE, vepër e parashikuar dhe dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së,**
- 2. S.J., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me akuzën 2, PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së, dhe me akuzën 3, MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së,**
- 3. G.L., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe me akuzën 2, PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**
- 4. G.Xh., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe me akuzën 2, PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**

5. **Q.R., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së, dhe me akuzën 3, MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së,**
6. **M.A., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**
7. **S.S., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe me akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**
8. **E.M., data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe me akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**
9. **A.Z., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe me akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së,**
10. **J.S., emri i babait X, data e lindjes X, i akuzuar me akuzën 1, MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, me akuzën 2, MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, me akuzën 3, MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, me akuzën 4, FURNIZIM DHE SHITJE E PAAUTORIZUAR E ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 327 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 372 i KPRK-së, me akuzën 5,**

MBAJTJE NË KONTROLL DHE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga Neni 374 i KPRK-së, dhe me akuzën 6, PËRDORIM I ARMËS, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 375 i KPRK-së.

Pasi mbajti shqyrtimet fillestare publike më 11 mars, 15 prill, dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor në publik më 25, 26 dhe 27 qershor, 22, 23, 24 dhe 26 korrik, 19 gusht, 10 dhe 11 shtator dhe 7, 8 dhe 14 tetor 2013 në prani të:

- të pandehurit z. V.J. dhe mbrojtësit të tij z. M.D.,
- të pandehurit z. S.J. dhe mbrojtësit të tij z. R.S.,
- të pandehurit z. G.L. dhe mbrojtësit të tij z. S.P.,
- të pandehurit z. G.Xh. dhe mbrojtësit të tij z. S.Sh.,
- të pandehurit z. Q.R. dhe mbrojtësit të tij G.E.,
- të pandehurit z. M.A. dhe mbrojtësit të tij M.M.,
- të pandehurit S.S. dhe mbrojtësit të tij D.R.,
- të pandehurit E.M. dhe mbrojtësit të tij S.Sy.,
- të pandehurit A.Z. dhe mbrojtësit të tij H.A.,
- të pandehurit J.S. dhe mbrojtëses së tij L.A.,
- Prokurorit Publik z. Maurizio Salustro

pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues, të mbajtur më 14 tetor 2013, në bazë të nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),

më 16 tetor 2013, në pajtim me nenin 366 të KPPK-së, shpall në publik këtë

A K T G J Y K I M

I pandehuri V.J.

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJE E TERRORIZMIT**, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur e të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste veprimtaritë e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës, dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon,

1. mori pjesë në një sulm që dëmtoi kontejnerin e policisë kufitare serbe, të vendosur në Bujanovc, dhe i shkaktoi lëndime të lehta trupore oficerit të policisë serbe B.M., duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar fishekësh të kalibrave të ndryshëm (në çdo rast mbi 100), në bashkëkryerje me G.Xh. dhe E.M.; sulmi u Dobrosin (komuna e Gjilanit), më 28 qershor 2012, rreth orës 04.00,

- posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar armësh (përfshirë pushkë mësymjeje, mitralozë dhe raketa-hedhës), të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me G.Xh., G.L., S.J., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R., në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri V.J. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, ORGANIZIM I NJË GRUPI TERRORIST, në shkelje të nenit 113 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 1 i KPRK-së, sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri organizoi dhe drejtoi një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, duke blerë armatime, uniforma dhe mjete të tjera të nevojshme për aktivitetet e grupit, duke vendosur se çfarë aktivitetesh duhej të kryheshin nga grupi, duke vendosur kur, ku dhe nga kush duhej të kryheshin aktivitetet të tilla, duke marrë pjesë personalisht në të paktën njërin prej sulmeve të kryera nga grupi, të përshkruara më lart, duke përcaktuar objektivat politike të grupit, përfshirë edhe duke diktuar marrjet përsipër të përgjegjësisë për sulmet e kryera nga grupi. Aktivitetet u zhvilluan në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

Akuza e KONTROLLIT DHE POSEDIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, kundër të pandehurit V.J. **REFUZOHET** sipas nenit 363 paragrafi 1.1 të KPP-së, sepse prokurori e tërhoqi akuzën.

I pandehuri V.J.

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 6 (gjashtë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (1) të Kodit Penal të Kosovës, me 7 (shtatë) vjet burgim dhe gjobë në shumën 1000 (një mijë) euro, në bazë të nenit 39 (1) dhe (2) të Kodit të fundit, që duhet paguar jo më vonë se 3 (tre) muaj pasi aktgjykimi të ketë marrë formë të prerë;

Në bazë të nenit 71 (1) (2), pika 2, të Kodit Penal të Kosovës, ndaj V.J. caktohet dënimi unik prej 9 (nëntë) vjetësh burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga V.J. do të llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

* * *

I pandehuri S.J.

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga neni 135

paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës, dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” për të dërguar forca paqeruajtëse në rajon, mori pjesë në një sulm që dëmtoi kontejnerin e policisë kufitare serbe, të vendosur në Bujanovc, duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar fishekësh të kalibrave të ndryshëm, në bashkëkryerje me E.M. dhe me një numër kryerësish të tjerë të paidentifikuar. Sulmi u Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 7 tetor 2012, rreth orës 21.35, dhe sepse ai posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar armësh (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupi terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., E.M., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R., në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri S.J. është gjetur fajtor edhe për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST**, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., E.M., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, duke përpiluar marrjet përsipër të përgjegjësive, duke kërkuar për armatime, duke kryer veprat penale të përshkruara më sipër, dhe përndryshe duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij. Aktivitetet u zhvilluan në një vend të papërcaktuar të Kosovës, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

Akuza e **KONTROLLIT DHE POSEDIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, kundër të pandehurit S.J. **REFUZOHET** sipas nenit 363 paragrafi 1.1 të KPPK-së, sepse prokurori e tërhoqi akuzën.

I pandehuri S.J.

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenet 136 (1) dhe 135 (1.10), me 6 (gjashtë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 4 (katër) vjet burgim;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj S.J. caktohet dënimi unik me 8 (tetë) vjet burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga S.J. do të llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **G.L.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJE E TERRORIZMIT**, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., A.Z., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S., në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri në 13 shkurt 2013.

I pandehuri G.L. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST**, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., A.Z., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, i cili kreu sulme ndaj objekteve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vendosur veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më sipër, në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri në 13 shkurt 2013.

I pandehuri G.L.

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 5 (pesë) vjet burgim;

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj G.L. caktohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga G.L. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **G.Xh.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t'i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, mori pjesë në një sulm që dëmtoi kontejnerin e policisë kufitare serbe, të vendosura në Bujanovc, dhe i shkaktoi lëndime të lehta trupore policit serb B.M., duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar fishekësh të kalibrave të ndryshëm (në çdo rast më shumë se 100), në bashkëkryerje me V.J. dhe E.M., në Dobrosin (Komuna e Gjilanit), më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00, dhe sepse ai posedonte dhe kontrollonte në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar armësh (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R., në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri G.Xh. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur “LEL”, duke kërkuar për armatim, duke kryer veprat penale të përshkuara më sipër, dhe përndryshe duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij, në një vend të papërcaktuar të Kosovës, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri **G.Xh.**

DËNOHET

Për veprën penale të përshkuar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 6 (gjashtë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkuar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim ;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj G.Xh. caktohet dënimi unik prej 6 (gjashtë) vitesh e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga G.Xh. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **Q.R.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJE E TERRORIZMIT**, në shkelje të nenit 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës, dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar armësh (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., S.S., në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri Q.R. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST**, në shkelje të nenit 113 (3) të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., S.S., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, i cili kreu sulmet ndaj objekteve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor, dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij, dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lart në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

Akuza e **KONTROLLIT DHE POSEDIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, kundër të pandehurit Q.R. **REFUZOHET** sipas nenit 363 paragrafi 1.1 të KPPK-së, sepse prokurori e tërhoqi akuzën.

I pandehuri **Q.R.**

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 5 (pesë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim ;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës ndaj Q.R. caktohet dënimi unik prej 5 (pesë) vitesh e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga Q.R. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **M.A.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë për ndërprerjen e aktiviteteve policore të saj në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës, dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar armësh (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., E.M., Q.R. në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri M.A. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., E.M. dhe Q.R., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, i cili ndër të tjera kreu sulmet ndaj objekteve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij, dhe duke kryer veprat penale të përshkuara më lart në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri **M.A.**

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 5 (pesë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim ;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës ndaj M.A. caktohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga M.A. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **S.S.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJE TË TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë të një grupit terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në

mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t'i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt "komunitetin ndërkombëtar" të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist "LEL", në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., dhe Q.R. në një vend të papërcaktuar, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri S.S. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht veprë e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M. dhe Q.R., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si "LEL", i cili kreu sulmet ndaj objekteve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vendosur veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij, dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lart në një vend të papërcaktuar të Kosovës, duke filluar nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri S.S.

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenet 136 (1) dhe 135 (1.10), me 5 (pesë) vjet burgim;

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës ndaj S.S. caktohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh;

Koha e kaluar në paraburgim nga S.S. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nënparagrafi 5, të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri E.M.

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJE E TERRORIZMIT, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht veprë e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si "LEL", me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste veprimtaritë e saj të policimit në rajonin e Bujanovcit, për t'i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës dhe për ta

detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” për të dërguar forca paqeruajtëse në rajon, mori pjesë në një sulm që dëmtoi kontejnerin e policisë kufitare serbe të vendosur në Bujanovc, dhe i shkaktoi lëndime të lehta trupore oficerit të policisë serbe B.M., duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar fishekësh të kalibrave të ndryshëm (në çdo rast më shumë se 100), në bashkëkryerje me V.J. dhe G.Xh. në Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00; sepse ai mori pjesë në një sulm mbi kontejnerin e policisë kufitare serbe, të vendosur në rajonin e Bujanovcit, duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar fishekësh të kalibrave të ndryshëm, në bashkëkryerje me S.J. dhe me një numër të paditur të kryerësve të tjerë në Dobrosin (komuna e Gjilanit), më 7 tetor 2012 rreth orës 21.35 dhe sepse ai posedonte dhe kontrollonte në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushkë mësymjeje, mitralozë dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A. dhe Q.R. në një vend të papërcaktuar, duke filluar më së voni nga fundi i prillit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri E.M. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST**, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur “LEL”, ndër të tjera duke kërkuar për armatime, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lart në një vend të papërcaktuar të Kosovës, duke filluar më së voni në prill 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri **E.M.**

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10) me 6 (gjashtë) vjet burgim;
Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim ;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës ndaj E.M. caktohet dënimi unik prej 6 (gjashtë) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga E.M. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPPK-së;

I pandehuri lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

I pandehuri **A.Z.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJE TË TERRORIZMIT**, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse u

vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL”, me qëllimin për ta detyruar në mënyrë të parregullt Qeverinë e Republikës së Serbisë që të ndërpriste aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, për t’i detyruar në mënyrë të parregullt pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës dhe për ta detyruar në mënyrë të parregullt “komunitetin ndërkombëtar” të vendoste forca paqeruajtëse në rajon, posedoi dhe kontrolloi në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushkë mësymjeje, mitraloza dhe raketa-hedhës), të cilat janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., Q.R., G.Xh., M.A., E.M. dhe S.S. në një vend të papërcaktuar, duke filluar jo më vonë se prilli 2012 dhe deri më 17 tetor 2012.

I pandehuri A.Z. u gjet fajtor edhe për akuzën 2, PJESEMARRJE NË NJË GRUP TERRORIST, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht veprë e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S., mori pjesë aktive në një grup terrorist të vetë-quajtur dhe të njohur si “LEL” (i cili ndër të tjera kreu sulmet ndaj objekteve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012), duke e vendosur veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimtaritë e tij dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lart në një vend të papërcaktuar, duke filluar jo më vonë se prilli 2012 dhe deri më 17 tetor 2012.

I pandehuri **A.Z.**

DËNOHET

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 1, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 136 (1) dhe 135 (1.10), me 5 (pesë) vjet burgim;

Për veprën penale të përshkruar në akuzën 2, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 113 (3) të Kodit Penal të Kosovës, me 2 (dy) vjet burgim;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj A.Z. caktohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga A.Z. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPPK-së;

Shpenzimet e procedurës penale në lidhje me veprat penale për të cilat të akuzuarit janë liruar nga akuzat, do të paguhet nga burimet buxhetore, sipas Nenit 453, paragrafi 2 të KPPK-së.

I pandehuri **J.S.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 4, FURNIZIM DHE SHITJE E PAAUTORIZUAR E ARMËVE, veprë e parashikuar dhe e dënuar nga neni 327 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht veprë e dënueshme nga neni 372 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri pa autorizim ndërmjetësoi dhe përfundoi një numër transaksionesh për shitjen e armëve të zjarrit të kalibrave të ndryshëm, përfshirë shitjen e armës së papërcaktuar të zjarrit të përmendur në akuzën 3 më lart, në një vend të papërcaktuar, më 7 nëntor 2012.

për akuzën 6, PËRDORIM I ARMËS, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 375 i KPRK-së, sepse me prova u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri përdori dhe shkrepi një armë që ai e posedonte në mënyrë të paligjshme, në një vend të papërcaktuar, në një datë të papërcaktuar para ose më 3 janar 2013.

Akuzat 1, 2, 3 dhe 5 të KONTROLLIT DHE POSEDIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, vepër e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, kundër të pandehurit J.S. REFUZHON sipas nenit 363 paragrafi 1.1 të KPPK-së, sepse prokurori i tërhoqi akuzat.

I pandehuri **J.S.**

DËNOHET

Për veprën penale të FURNIZIMIT DHE SHITJES SË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 327 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 372 i KPRK-së, e përshkruar në akuzën 4, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 327 (1), me 2 (dy) vjet burgim;

Për veprën penale të përdorimit të armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 375 i KPRK-së, e përshkruar me akuzën nga 6, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 328 (1) të Kodit Penal të Kosovës, me 1 (një) vit burgim;

Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj J.S. caktohet dënimi unik prej 2 (dy) vitesh dhe 2 (dy) muajsh burgim;

Koha e kaluar në paraburgim nga J.S. llogaritet në dënim, sipas nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së;

Kostoja e procedurës penale në lidhje me veprat penale për të cilat i akuzuari është liruar nga akuzat, do të paguhet nga burimet buxhetore, sipas Nenit 453, paragrafi 2 të KPPK-së.

ARSYETIM

Historia procedurale

Më 20 shkurt 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë kundër V.J., i përfaqësuar nga mbrojtësi M.D., S.J., i përfaqësuar nga mbrojtësi R.S., G.L., i përfaqësuar nga mbrojtësi S.P., G.Xh., i përfaqësuar nga mbrojtësi S.Sh., Q.R., i përfaqësuar nga Gafurr Eshani, M.A., i përfaqësuar nga mbrojtësi M.M., S.S., i përfaqësuar nga mbrojtësi D.R., E.M., i përfaqësuar nga mbrojtësi Xh.Xh., A.Z., i përfaqësuar nga mbrojtësi H.A., dhe J.S., i përfaqësuar nga mbrojtësja L.A.

V.J. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), akuzën 2, organizimi i një grupi terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe akuzën 3, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së.

S.J. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të KPRK-së, akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, dhe akuzën e 3, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar sipas nenit 328 të Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së.

G.L. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK.

G.Xh. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10, 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së.

Q.R. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të KPRK-së, akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së, dhe akuzën 3, kontroll dhe posedimin i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së.

M.A. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i akuzës KPRK 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 (2) i KPRK-së.

S.S., emri i babait Daut, data e lindjes 3 prill 1976, u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të KPRK-së, dhe akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së.

E.M. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së.

A.Z. u akuzua me akuzën 1, kryerje e terrorizmit, në shkelje të neneve 109 paragrafi 1 n. 10 dhe 110 paragrafi 1 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 135 paragrafi 1.10 dhe 136 pika 1 të KPRK-së, dhe akuzën 2, pjesëmarrje në një grup terrorist, në shkelje të nenit 113 paragrafi 3 të KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së.

J.S. u akuzua me akuzën 1, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, akuzën 2, kontroll dhe posedimin i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, akuzën 3, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 328 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 374 i KPRK-së, akuzën 4, furnizim dhe shitje e paautorizuar e armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 327 i KPK-së, aktualisht vepër e dënueshme nga neni 372 i KPRK-së, akuzën 5, kontroll dhe posedimin i paautorizuar i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 374 i KPRK-së, dhe akuzën 6, përdorim i armëve, e parashikuar dhe e dënuar nga neni 375 i KPRK-së.

Më 11 mars 2013 u mbajt shqyrtimi fillestar, në pajtim me nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale, nr 04/L-123 (KPPK). Në marrëveshje me mbrojtjen, u lexua përkthimi në shqipe i akuzave të aktakuzës. Të gjithë të pandehurit u vetë-deklaruan jo fajtorë. Gjatë seancës, të gjithë mbrojtësit u ankuan se kishin pasur qasje në prova vetëm si CD, dhe se nuk u ishin dhënë materiale provuese të printuara. Kryetari i trupit gjykues i kujtoi mbrojtjes mundësinë për t'i kundërshtuar provat sipas nenit 249 të KPPK-së dhe të kërkonte që aktakuza të hidhet poshtë, sipas nenit 250 të KPPK-së. Të gjithë mbrojtësit kërkuan që të hiqen masat kufizuese ndaj të mbrojturve të tyre. Kryetari i trupit gjykues i hodhi poshtë kërkesat.

Shqyrtimi i dytë u mbajt më 14 prill 2013. Kryetari i trupit gjykues vuri në dukje se disa prej mbrojtësve kishin kundërshtuar provat dhe kishin kërkuar të rrëzohej aktakuza. Mbrojtësit u ankuan sërish se prokuroria u kishte dhënë atyre skanime dhe jo fotokopje të provave. Kryetari i trupit gjykues i udhëzoi mbrojtësit të njoftojnë gjykatën dhe akuzën për vijën e tyre të mbrojtjes, në bazë të nenit 256 të KPPK-së. Mbrojtësi M.D. njoftoi se do të paraqiste alibi për klientin e tij, V.J., dy vajza me emrin T. dhe L. nga komuna X dhe kamerierët që kishin punuar në [restorant] gjatë natës së datës 28 qershor 2012. Mbrojtësi S.Sh. parashitroi në emër të G.Xh. se e njëjta gjë vlente edhe në rastin e tij, sepse ai kishte qenë bashkë me V.J. atë natë.

Mbrojtja paraqiti kundërshtime ndaj provave, sipas nenit 249 të KPPK-së, dhe bëri kërkesa për rrëzimin e aktakuzës, sipas nenit 250 të KPPK-së. Me vendim të 8 majit 2013, kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesat për rrëzimin e aktakuzës u refuzuan si të pabaza. Mbrojtësit paraqitën ankesa kundër këtij vendimi dhe gjykata themelore ia përcolli ato Gjykatës së Apelit më 23 maj 2013. Me aktvendim të datës 12 qershor 2013, Gjykata e Apelit i hodhi poshtë ankesat si të pabaza.

Lënda kaloi për shqyrtim gjyqësor dhe seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor u mbajt më 25 qershor 2013. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor qenë publike, ku të pranishëm ishin të

gjithë të pandehurit dhe mbrojtësit e autorizuar të tyre, si dhe Maurizio Salustro si prokuror publik, herë pas here i zëvendësuar. Seanca u desh të shtyhej për shkak se mbrojtësit e S.S. dhe A.Z. nuk ishin të pranishëm. Më 26 qershor 2013, kryetari i trupit gjykues i informoi të pandehurit me akuzën dhe përbërjen e trupit gjykues. Nuk pati kërkesa për përjashtimin e ndonjë anëtari të trupit gjykues. Në marrëveshje me mbrojtjen, u lexua një përmbledhje e akuzave, në pajtim me nenin 324 të KPPK-së. Të gjithë të pandehurit u vetë-deklaruan jo fajtorë. Të pandehurit u informuan për të drejtën e tyre sipas nenit 323 të KPPK-së. U paraqitën deklaratat e hapjes, në pajtim me nenin 328 të KPPK-së. Prokuroria vazhdoi me dëgjimin e regjistrimeve të përgjimeve telefonike sipas rendit të të përmendurve në aktakuzë. Më 27 qershor 2013, prokuroria vazhdoi përsëri me dëgjimin e regjistrimeve të përgjimeve telefonike. Më 22 korrik 2013 u mor në pyetje dëshmitari K.M.. Më 23 korrik 2013 u morën në pyetje ekspertët H.H. dhe S.Z.. Më 24 korrik 2013 u mor në pyetje eksperti F.L.. Më 26 korrik 2013, Prokuroria paraqiti si prova raportet e përmendura në aktakuzë. Në pyetje u morën dëshmitarët M.R.B. dhe F.G. Më 19 gusht 2013 u mor në pyetje eksperti L.R. Prokuroria vazhdoi me paraqitjen si prova të fotografive dhe raporteve të përmendura në aktakuzë. I pandehuri V.J. u mor në pyetje në lidhje me deklaratat e tij të mëparshme. Të pandehurit S.J., G.L. dhe G.Xh. u morën në pyetje në lidhje me deklaratat e tyre të mëparshme. Më 11 shtator 2013 u morën në pyetje të pandehurit Q.R., M.A., S.S., E.M. dhe J.S. në lidhje me deklaratat e tyre të mëparshme. Më 26 shtator 2013 u mor në pyetje A.Z. në lidhje me deklaratat e tij të mëparshme. Prokurori parashtrori se, në bazë të nenit 8 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit numër 4/L-209 për Amnistinë dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 1.1.10 dhe 1.2.5, ai mori vendim për t'u dhënë amnisti dhe bazuar në Nenin 3 paragrafi 1.1.10 dhe 1.2.5 këtyre të akuzuarve për akuzat e mëposhtme: V.J., për Akuzën 3, Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, S.J., përsëri për Akuzën 3, Q.R., për Akuzën 3 dhe që përfshin Akuzën 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8; J.S., për akuzat 1, 2, 3 dhe 5. Më 07, 08 dhe 14 tetor 2013, prokuroria dhe mbrojtja paraqitën fjalimet e tyre përfundimtare.

Aktgjykimi u shpall më 16 tetor 2013. Kryetari i trupit gjykues shqiptoi aktvendimin e datës 16 tetor 2013 për vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurve V.J., S.J., G.L., G. [m.b.th. G.Xh.] Xëmshiri dhe E.M., derisa aktgjykimi të bëhej përfundimtar, për zëvendësimin e masës së arrestit shtëpiak me paraburgimin kundër të pandehurve Q.R., M.A., S.S. dhe A.Z., derisa aktgjykimi të bëhej përfundimtar, dhe për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit J.S., derisa aktgjykimi të bëhej përfundimtar. Aktvendimi u apelua dhe, me aktvendimin e datës 25 tetor 2013, Gjykata e Apelit Ia në fuqi aktvendimin dhe hodhi poshtë ankesat si të pabaza.

Me rastin e vendosjes për çështjen e përgjegjësisë penale që u atribuohet të pandehurve, ky trup gjykues shqyrtoi në mënyrë të veçantë provat e mëposhtme:

28/06/2012 – Raporti i Policisë për këqyrjen e vendit të ngjarjes – Dosja 1 C

Raporti i njësisë forensike të policisë së Kosovës në lidhje me provat e sekuestruara më 28/06/2012

14/08/2012 – Raporti i Shërbimit (ekzaminimi forensik i provave të sekuestruara më 18/05/2012)

29/10/2012 – Raporti i Shërbimit (Analiza e DVD-së D8 – dosja e dokumenteve strukturë/prova nga Interneti/Fotografi) me 9 bashkëngjitje – Dosja 6, 20

01/07/2012 – Raporti mbi aktivitetet e kontrollit të kryer më 01/07/2012 në ambientet e Q.R., datëlindja 15/03/1993, dhe lista e bashkëngjitur me sendet e sekuestruara – Arrestimi dhe kontrollet 17

26/09/2012 – Raporti i Shërbimit (Analiza e një ditari të gjetur tek V.J. dhe S.J.) dhe 5 bashkëngjitje – Dosja 4, 6

21/06/2012 – Raport i 15 ditëve të para (numrat +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX) me bashkëngjitjet – Dosja 1 D

28/11/2012 – Raporti i Shërbimit lidhur me transferimin e linjave të ndërprera të përgjuara me bashkëngjitjen: CD lidhur me përgjimet e V.J. – Dosja 6, 16

30/08/2012 – Raporti 15 ditor i masave të fshehta për numrat e mobilit +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX (V.J. dhe E.M.) – Dosja 3, 10

04/10/2012 – Raporti i Shërbimit (raporti vijues për provat e sekuestruara gjatë kontrolleve tek V.J. dhe shtëpia e G.Xh. më 01/07/2012) me 8 bashkëngjitje – Dosja 5, 15

05/10/2012 – Raporti i Shërbimit (analiza e “DVD-së B8 – Dokumentet” e nxjerra nga kompjuteri i V.J. dhe S.J.) dhe 9 bashkëngjitje – Dosja 5, 14

01/10/2012 – Raporti i Shërbimit (fletore me dorëshkrim, e sekuestruar në shtëpinë e vëllait të J.) – Dosja 4, 4

27/12/2012 – Raporti i Shërbimit (analiza e 2 DVD-ve të shënuara Y2 8 pjesa 1 dhe 2 nga kompjuteri i S.J.) dhe 5 bashkëngjitje – Dosja 6, 4

16/10/2012 – Raporti i Kontrollit, Ekzekutimi i urdhër-kontrollit të dhënë gojarisht nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe lista bashkëngjitur e provave të sekuestruara – Arrestimet dhe Kontrollet 5

08/10/2012 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 5, 12

2012/05/07 – Raporti i dytë 15 ditor, numrat mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX dhe 10 bashkëngjitje, Dosja 2, 18

11/07/2012 – Raporti 15 ditor, përgjimi i numrit 044.290.130, i përdorur nga Mentori – Raporti i shërbimit, Dosja 2, 16

30/08/2012 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 3, 10

20/07/2012 – Raporti i tretë 15 ditor, numrat mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX dhe 7 bashkëngjitje, Dosja 2, 15

16/11/2012 – Raporti i Shërbimit (Analiza e laptopit asusPro50 SN 82NOASO47055 – A2, i sekuestruar tek Q.R.) – Dosja 6, 19

01/07/2012 – Raporti i Arrestimi për paraburgimin e V.J. – Arrestimet dhe kontrollet 15

30/08/2012 – Raporti 15 për masat e fshehta ndaj numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 3, 10

09/07/2012 – Raporti i parë 15 ditor për Mbikëqyrjen e kryer më 25, 26, 28, 29 dhe 30 qershor dhe 1 korrik 2012 – Dosja 2, 17

23/01/2013 – Raporti i Shërbimit “Analiza e përmbajtjes së DVD-së, Mobilëve karta + disketave + kartave të kujtesës” – Dosja 8, 2

10/09/2012 – Raporti i Shërbimit (Ekzaminimi forensik i provave të sekuestruara më 28/06/2012) – Dosja 3, 1

15/11/2012 – Raporti i Shërbimit (Analiza e matjeve të antenave Z-Mobile për datat 27/28 qershor 2012) – Dosja 6, 21

2012/08/10 – Raporti i Policisë për këqyrjen e vendit të ngjarjes

08/10/2012 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX (S.J., A.Z., G.L.) – Dosja 5, 12

08/10/2012 – Raporti i shërbimit (pozicioni i mobilëve të G.L., S.J. dhe E.M. më 7/10/2012) dhe 5 bashkëngjitje – Dosja 5, 10

21/06/2012 – Raporti i parë 15 ditor, numrat e telefonit +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 1 D

15/08/2012 – Raporti i pestë 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrit të telefonit +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 3, 20

29/08/2012 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrit të mobilit +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 3, 11

23/10/2012 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, ++XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 5, 4

22/11/2012 – Raporti 15 ditor për përgjimin e numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX dhe +XXX(X)XXXXXXXXX dhe 11 bashkëngjitje – Dosja 6, 18

04/01/2013 – Raporti i Njësisë Forensike IT të NJHKO-së për ekzaminim e provave – Dosja 8, 6

14/01/2013 – (duhet të jetë 15/01/2013) Raporti 15 ditor për përgjimin e numrit mobil +XXX(X)XXXXXXXXX (J.S.) – Dosja 8, 12

22/11/2012 – Raport 15 ditor, përgjimi i numrave mobilë +XXX(X)XXXXXXXXX, +XXX(X)XXXXXXXXX dhe 11 attachments, Dosja 6, 18

2012/07/11 – Raporti 15 ditor për masat e fshehta ndaj +XXX(X)XXXXXXXXX dhe +XXX(X)XXXXXXXXX – Dosja 6, 22

Shqyrtimi i provave që tregojnë përgjegjësinë individuale të të pandehurve për veprat penale specifike

V.J.

A. Organizimi i një grupi terrorist.

1. Raporti i 15 ditëve të para, i datës 21/06/2012 (dosja 1, 21 me bashkëngjitje)

Në këtë raport analizohen një sërë bisedash të përgjuara telefonike mes J.S. dhe V.J., në bazë të urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Gjilan. Urdhri për përgjimin u lëshua në lidhje me zbulimin nga patrulla e KFOR-it të armëve të fshehura në Kamenicës.

Bisedat e përgjuara të analizuar në këtë raport konkret patën rëndësi të veçantë për trupin gjykues, sepse ato zbuluan rolin që luante i pandehuri V.J. në organizimin e grupit terrorist, të njohur si “LEL”. Bisedat e mëposhtme të përgjuara e përshkruajnë V.J. si organizator dhe koordinator i aktiviteteve të ndërmarra nga kjo organizatë terroriste e vetë-organizuar:

Më 13/06/2012, në orën 21:50, Q.R. thirri V.J.: V.J. thotë: “Jemi 8-9”. Ai shton se një herë tjetër do të ketë vend edhe për kushëririn e Q.R.. Ai thotë se kjo punë nuk është e përshtatshme për të, pasi “ajo gjë nuk është shumë e përshtatshme, është tepër e rëndë për t’u mbajtur në dorë”.

Më 07/06/2012, nga ora 12:26 deri në orën 13:06, u bënë disa thirrje nga G.Xh. për V.J.: diskutimi është për blerjen e një uniforme gjermane, sepse V.J. ka blerë vetëm 5 uniforma. V.J. i kërkon G.Xh. të thërrasë Q.R., V.J. i thotë “ne do të shkojmë dhe do të jemi dy grupe, një grup me mua dhe një tjetër me S.”. V.J. gjithashtu thotë se është më mirë që të takohen në Prishtinë, “sepse shumica juaj jeni fytyra të panjohura dhe pastaj do të ndahemi në grupe dhe do të vendosin se në cilin drejtim të shkojmë”. Pastaj ai mëson se uniforma gjermane nuk gjendet, prandaj V.J. thotë “në rregull, këtë herë do të shkojmë kështu, por mbaje mend se nuk mund ta diskutosh këtë – thuaja edhe Q.R.”.

Më 08/06/2012 (4:02), V.J. thirri Q.R.: Q.R. thotë se ata do të vijnë poshtë, V.J. thotë “Përpiquni t’i rivendosni ato gjëra”, Q.R. thotë se ata janë shumë të lodhur.

Bisedat e mëposhtme treguan se V.J. ishte gjithashtu ai që thoshte fjalën i fundit për pjesëmarrjen e anëtarëve të veçantë në aktivitetet e “LEL”:

Në 05/06/2012, në orën 16:16, G.Xh. thirri V.J., i cili i thotë atij se “V.” [d.m.th. E.M.] nuk mund të vijë. V.J. thotë “Të bësh 14 km për një nuk ia vlen” dhe shton ““V.” [d.m.th. E.M.]mund të pushojë këtë herë”.

Më 18/06/2012 (19:03), G.Xh. thirri V.J.: V.J. i tregon atij se “Nesër ‘S.’ dhe ‘A.’ do të shkojnë dhe survejojnë nëse po lëviz gjë atje, që ne të mos shkojmë atje dhe të rrimë për asgjë”; “Ne nuk do të shkojnë me tomahokë në duar”.

Më 17/06/2012, nga ora 16:09 deri në orën 16:44, u regjistruan një sërë kontaktesh midis V.J., M.A. dhe A.Z. V.J. thotë “Bëhuni gati për ato që dini”.

Përgjimet e tjera telefonike treguan qartë se V.J. ishte gjithashtu i vetëdijshëm për nevojat e grupit, që do të thotë se ai e dinte se çfarë nismash do të merren dhe çfarë pajisjesh janë të nevojshme për t’i realizuar ato, dhe përpiqet t’i zgjidhë ato:

Më 15/06/2012, në orën 22:59 (më pak se dy ditë para sulmit të parë), G.L. thirri V.J., dhe i tha atij se kishte gjetur “Një palë sy që mund t’i shohësh natën prandaj mund t’i huazosh.” V.J. thotë “Mirë është, do të të njoftoj një ditë përpara”.

Më 06/06/2012, në orën 12:12, Q.R. thirri V.J. Ky i fundit i kërkon atij të gjejë “Disa lloj këpucësh në të cilat mund të ecni”.

Më 17/06/2012, në orën 12:32, Q.R. thirri V.J. V.J. i thotë “Dëgjo, deri të hënën ose të martën do t’ju njoftoj”. Q.R. thotë “Në rregull, por duhet t’u themi të tjerëve të marrin me vete qesen, ujë...”. V.J. thotë: “Po, e dinë.”

Disa biseda të tjera të përgjuara ilustrojnë se V.J. ishte personalisht përgjegjës për prokurimin e armëve dhe uniformave për grupin, përfshirë ndërmjetësin J.S., dhe si pikë koordinimi për të tjerët të cilët ishin aktivë në këtë drejtim, konkretisht Q.R., G.Xh. dhe G.L.

Më 04/06/2012 ka një shkëmbim thirrjesh telefonike midis G.Xh. dhe V.J. G.Xh. do të takohet me dikë për të parë diçka që i intereson V.J.t. Menjëherë pas kësaj ka një telefonatë tjetër në të cilën G.Xh. e informon V.J. se është “e markës kineze, gjysmë-automatike”, dhe se “kur tërheq këmbëzën, ajo ka një pozicion që [...] do të shpërthejë në automatike si 10-shja.” V.J. pyet “A mund ta shohësh krehërin?” Dhe G.Xh. përgjigjet “Duket njësoj si 30, si ato të Serbisë”. Çmimi është 330 euro.

Më 10/06/2012, në orën 16:46, V.J. thërret G.L., i cili i thotë atij se një person “Ka një pulë të rëndë me 30 zogj dhe kushton 300”. V.J. përgjigjet se nuk ka të holla, por ai thotë “Kontrolloje në fillim nëse punon apo jo”.

Më 06/06/2012, në orën 16:44, V.J. thërret Q.R. dhe e pyet nëse “G. [d.m.th. G.Xh.]” e ka thirrur Q.R. Pastaj ai njofton Q.R. se “Ata nuk mundën ta sjellin sot mitralozin”.

Të gjitha këto përgjime tregojnë qartë rolin drejtues të ushtruar nga V.J. “ brenda “LEL”, si organizator dhe udhëheqës i kësaj organizate terroriste.

2. Të dy deklaratat e të pandehurit V.J. dhënë gjatë hetimit dhe shqyrtimit kryesor u përqendruan në akuzën e organizimit të një grupi terrorist dhe të kryerjes së terrorizmit.

V.J. u mor në pyetje më 1 korrik 2012 dhe 18 shkurt 2013 dhe u informua për të drejtat e tij dhe në prani të mbrojtësit. Në veçanti, ai u njoftua se, nëse zgjedh të japë deklaratë apo t’u përgjigje pyetjeve, ai nuk do të jetë nën betim dhe informacioni që jep, mund të përdoret si provë para gjykatës. V.J. deklaroi: *“Së pari do të doja të them se jam kryetari i “LEL”. Kjo lëvizje është lëvizje politike e cila është aktive në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (...). Qëllimi i lëvizjes është të shprehë pakënaqësinë për shkeljet dhe padrejtësitë e kryera kundër popullit tonë (shqiptarëve) nga Qeveria e Serbisë. Unë jam ish-veteran i luftës së UÇPMB-së (Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit).”*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 19 gusht 2013, ky i pandehur konfirmoi dëshmitë e tij të mëparshme, të dhëna gjatë hetimit, vetëm me disa ndryshime të vogla që nuk e ndryshuan përmbajtjen e përgjithshme të dëshmive të tij.

Deklaratat e V.J. kanë rëndësi vendimtare jo për shkak se ai dha vullnetarisht informata të caktuara të paditura më parë nga hetuesit, por për shkak se në ballafaqim me dëshmi të tjera të besueshme, ato tregojnë se V.J. u shty thellësisht nga ideologji ekstremiste, që synonte arritjen e qëllimeve të veta jo me zgjidhje paqësore, të miratuar politikisht, por me armatime dhe përdorim të dhunës.

Gjatë marrjes së parë në pyetje më 1 korrik 2012, V.J. pranoi se nënshkroi komunikatën e pranimit të përgjegjësisë së “LEL” për sulmet terroriste më 17 maj dhe 28 qershor të vitit 2012. Në rastin e sulmit të datës 28 qershor 2012, ai përshkroi se e përgatiti këtë mesazh në kompjuterin që i përket vëllait të tij. Gjatë marrjes së dytë në pyetje më 18 shkurt 2013, ai thjesht e mohoi dëshminë e tij të mëparshme dhe fajësoi përkthimin si burim të keqkuptimit. Ky qëndrim tregon qartë se V.J. nuk e ka fare problem ta ndryshojë dëshminë e tij kur e konsideron më të përshtatshme për ta paraqitur atë në dritë më të favorshme. I pandehuri duket se nuk kujdeset shumë për t’i dhënë trupit gjykues argumente më bindëse se përkthimi. Trupi nuk e gjeti bindës këtë argument, sepse prania e përkthyesit u siguroi në të dy rastet dhe i pandehuri i nënshkroi të gjitha proces-verbalet. Për mendimin e trupit gjykues, ky i pandehur dëshiron të shmangë përgjegjësinë penale për veprat penale me të cilat është akuzuar.

Kur u ballafaqua me fotografi të ndryshme të gjetura gjatë kontrollit në banesën që i përket atij dhe vëllait të tij S.J., ai konfirmoi identitetin e personave të përshkruar në foto dhe identifikoi shumicën e tyre. Kur u pyet se kur dhe ku ishin bërë fotografitë, V.J. përdori si justifikim humbjen e kujtesës. Kur u mor në pyetje në rastin e dytë më 18 shkurt 2013, në lidhje me të njëjtat fotografi, V.J. e ndryshoi dëshminë e tij në mënyrë të konsiderueshme,

duke pretenduar këtë herë që ato foto ishin bërë në vitin 2000/2001 gjatë kohës kur V.J. shërbente si ushtar në UÇPMB. Ky shpjegim u konsiderua si kundërthënës, sepse mbetet në kundërshtim me provat objektive, d.m.th. me të dhënat e përgjithshme të marra kur u bënë fotografitë në fjalë, duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë datën e saktë kur janë marrë fotografitë. Ky informacion i përgjithshëm është ruajtur jo vetëm në kartën e kujtesës të kamerës së përdorur, por edhe në kompjuterin e sekuestruar në vendbanimin e vëllezërve J. Mbrojtja nuk arriti të provojë se ndonjë person tjetër, krahas vetë të pandehurit dhe vëllait të tij S.J., kishte qasje në këto të dhëna të përgjithshme të fotografive të bëra. Trupi gjykues vuri në dukje se askush nuk kishte ndonjë motiv të ndryshonte të dhënat, duke nxjerrë si pasojë përfundimin se V.J. dhe të pandehurit e tjerë kishin marrë pjesë në llojin e ekspeditës stërvitore pak para se të ndërmerreshin sulmet. Krahas kësaj, trupit gjykues nuk i shpëtoi nga vëmendja se krahasimi me fotografitë i pamjes së të pandehurve gjatë shqyrtimit gjyqësor, të çon në përfundimin që është pikërisht i njëjtë, në asnjë rrethanë njerëzit në fotografi nuk janë dhjetë vjet më të rinj, siç pretendon V.J. Duke marrë parasysh vetëm fotot e V.J., i shoqëruar nga njerëz të armatosur, përfundimi është se V.J. nuk mund ta paraqesë veten si kryetar/ish-kryetar i “LEL”, i cili formoi vetëm qëllimet politike dhe paqësore të lëvizjes. Fotografitë tregonin qartë se V.J. të paktën kishte dijeni për veprimet ushtarake të ndërmarra nga lëvizja, sepse ai mori pjesë në stërvitjen ku anëtarët u mësuan me armët.

Përveç deklaratës, fotografive dhe bisedave të përgjuara të tij, ka prova të tjera që të shpjen në përfundimin e padyshimtë, pavarësisht se çfarë pretendon V.J. në mbrojtjen e tij, se ai luajti rol drejtues brenda “LEL”, si organizator.

Provat e sekuestruara gjatë kontrolleve në vendbanimin e V.J. dhe S.J. më 1 qershor 2012.

Gjatë kontrollit të kryer më 1 korrik 2012 në vendbanimin e vëllezërve J., policia gjeti prova shumë të rëndësishme që tregojnë nivelin e përfshirjes së V.J. në sjelljen e përditshme të “LEL”:

- vulosi dhe nënshkroi origjinalin e komunikatës lidhur me sulmin më 28 qershor 2012;
- vula zyrtare e Lëvizjes përputhet me vulën e gjetur në marrjen përsipër të përgjegjësisë;
- materiale të ndryshme lidhur me aktivitetet e “LEL”, përfshirë statutin, rregulloret dhe formularin e aplikimit të saj;
- manuale ushtarake, foto, dhe skica që kanë të bëjnë me aktivitete ushtarake dhe armë;
- kompjuteri personal që përmban dokumente elektronike që kanë të bëjnë me terrorizmin, balistikën, argumente paraushtarake, marrje peng (Beslan, Briri i AfrikëS.), lëndë plasëse, kryengritje, dhe të ngjashme;
- harta nga Google Earth të rajonit të Dobrosinit, të gjetura në të njëjtin PC;

- një pistoletë.

Të gjitha këto prova vendimtare të shqyrtuara veç e veç dhe në tërësi të çojnë në përfundimin se V.J. ishte udhëheqës aktiv i “LEL”, i cili koordinonte aktivitetet e saj terroriste si prokurues i burimeve të saj dhe si pikë qendrore. Trupi gjykues nxori një përfundim të vlefshëm dhe të qartë në lidhje me qëllimet e lëvizjes në fjalë pasi vlerësoi provat. “LEL” nuk ishte një platformë politike e përqendruar në arritjen e qëllimeve në mënyrë paqësore, por një organizatë terroriste që i kishte ndërtuar burimet e saj njerëzore dhe ushtarake me qëllimin e qartë për të filluar një konflikt tjetër ushtarak në rajon dhe V.J. ishte organizator plotësisht përkushtuar i saj.

2. Kryerja e terrorizmit nëpërmjet sulmit të 28 qershorit 2012 në lidhje me V.J., G.Xh. dhe E.M.

Më 28 qershor 2012, rreth orës 4:00, pika e kontrollit e policisë serbe e ndodhur në Dobrosin u sulmua me armë zjarri. Gjatë këtij sulmi, një polic serb, B.M., u plagos lehtë. Sipas raportit të përgatitur nga njësi forensike e Policisë së Kosovës, në vendngjarje u gjetën 157 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 2 7,62 mm dhe 7,9 x39 x57 mm.

- Armë e kalibrit 7.62x39 mm armë, me të cilën u shkrepën 44 predha të gjetura të kalibrit të njëjtë;
- armë e kalibrit të njëjtë, me të cilën u shkrepën 24 predha të tjera të kalibrit të njëjtë;
- armë e kalibrit 7.62x54 mm, me të cilën u shkrepën 93 predha të gjetura të kalibrit të njëjtë.

Ditën tjetër, “LEL” publikoi një komunikatë në internet, duke marrë përsipër përgjegjësinë për sulmin.

Gjatë hetimit u mblodh një numër dërmues provash të cilat u paraqitën në shqyrtimin gjyqësor dhe që vërtetuan se sulmin e kryen anëtarët e “LEL”: V.J., G.Xh. dhe E.M.

V.J. mohoi të kishte marrë pjesë në sulmin terrorist më 28 qershor 2012 dhe paraqiti versionet e tij të ngjarjeve në ditën kritike. Vija e mbrojtjes e tij duket se është se në ditën kritike ai ishte së bashku me G.Xh. krejt rastësisht në Gjilan, ku ai kaloi ca kohë i shoqëruar nga dy femra. Në një moment të caktuar, ai mori një telefonatë që e informoi se një shok është plagosur në Podgragje dhe ai duhet të vijë për ta marrë. Kështu, V.J. së bashku me G.Xh. shkoi në Podgragje për ta marrë atë person, por kjo nuk ndodhi, sepse ai person nuk mund ta kalonte kufirin. Kur V.J. dhe G.Xh. kuptuan se policia serbe ishte afër tyre, ata u nisën për në Prishtinë.

Kjo linjë e mbrojtjes nuk u konsiderua e besueshme nga trupi gjykues, pasi është në kundërshtim të dukshëm me provat e besueshme të paraqitura nga prokuroria.

Para së gjithash, një sërë bisedash telefonike, të renditura në raportet e policisë, demonstrojnë se anëtarët e “LEL” bënë përgatitje, përfshirë mbikëqyrjen e vendit të sulmit.

Në orët e mbrëmjes më 27 qershor 2012, pak para sulmit në ditën kritike, u përgjuan një varg bisedash telefonike mes V.J., G.Xh. dhe E.M.:

Në orët e mbrëmjes të së njëjtës ditë, 27 qershor 2012, fillon një aktivitet telefonik i jashtëzakonshëm midis V.J., E.M. dhe G.Xh.:

- Në orën 19:40, V.J. thirri G.Xh.; V.J. kërkon mendimin e G.Xh. për t'i kërkuar veturën “V.”, G.Xh. mendon se ai – “V.” [d.m.th. E.M.]– do t'i merrte në veturën e tij; V.J. thotë “*nëse po, ne mund të shkojmë sonte për t'i vënë ato të treja në automjet dhe për t'i vendosur tek rubineti*”;
- Në orën 19:44, G.Xh. thirri E.M., thirrja mbaron në orën 19:46;
- Në orën 20:00, G.Xh. i dërgon një SMS V.J. “*Të lutem më telefono në 044791314*” (numri i G.Xh.);
- Në orën 20:01, V.J. thirri G.Xh.; G.Xh. thotë se “*E.M. pajtohet, por nesër në orën 10:00 ai duhet të jetë në Universitet*”;
- Në orën 20:03, G.Xh. thërret E.M., thirrja mbaron në orën 20:07;
- Në orën 20:08, G.Xh. thërret V.J.:
 - G.Xh. sapo ka folur me E.M. dhe ai është gjithashtu i interesuar të marrë pjesë në aksion.
 - G.Xh. e pyet nëse ata do të bëjnë “ndonjë punë sot”; V.J. thotë: “*Po, me siguri*”;
 - G.Xh. do ta pyesë E.M. dhe nëse ai bie dakord, ata do të nisen dhe ta marrin.
- Në orën 20:14, G.Xh. thërret V.J.; G.Xh. i tregon V.J.t se ai ra dakord me E.M., por nëse ai mund të kthehet deri në orën 11:00. Për çdo gjë bihet dakord: E.M. do të marrë G.Xh. në Ferizaj dhe më pas ata do të shkojnë në Prishtinë për të marrë V.J.
- Në orën 20:19, V.J. thërret një person të panjohur dhe i tregon atij se ai është në rrugë për në Gjilan dhe e pyet nëse “të tjerët” duan të bashkohen, nëse po, ai duhet të gjejë rrugën për në Pograxha.
- Në orën 20:55, V.J. thërret G.Xh., i cili është ende duke pritur për “atë person” për ta marrë. V.J. i thotë G.Xh. se kur të jenë në Prishtinë, ata mund ta marrin atë në stacionin e autobusëve.

- Në orën 21:56, V.J. thërret G.Xh.: G.Xh. thotë se ata janë tek rrethi, V.J. është në stacionin e autobusëve, dhe ata duhet të hyjnë brenda dhe të tregojnë tek porta se ata do të shkojnë tek M.
- Në orën 00:11, V.J. merr një SMS në mobilin e tij; mobili i tij aktivizon antenën e vendosur në zonën e Gjilanit.

Këto telekomunikime të përgjuara në mënyrë të ligjshme janë tregues i qartë se këta të pandehur po bënin përgatitje për të ndërmarrë sulmin mbi pikën e kontrollit të policisë serbe. Provat më bindëse dalin nga pozicionimi i mobilëve të të pandehurve në zonën ndodhi sulmi terrorist. Mobili i G.Xh. më 28 qershor aktivizoi antenën GSM Capari_2 në orën 02:38:33 dhe në orën 02:38:41 (SMS nga një numër teknik). Mobili i V.J. më 28 qershor aktivizoi antenën GSM Pograxha_1 në orën 05:58:49. Mobili i E.M. më 28 qershor aktivizoi antenën GSM Pograxha_1 (ai mori një sërë SMS-sh nga një numër teknik) në orën 05:57:34, 05:57:41, 05:57:50, 05:57:55.

Dëshmia më inkriminuese del nga përmbajtja e thirrjes telefonike në orën 05:58:49 ndërmjet V.J. dhe G.Xh., gjatë së cilës V.J. tha: “Policia kufitare sapo shkoi lart... hiqe veturën sa më shpejt të jetë e mundur dhe eja në Pograxha.” Në përgjigje G.Xh. konfirmon: “Në rregull.” Në raportin e policisë u shpjegua se gjatë kësaj bisede u aktivizua një antenë celulare në Pograxha, që është afër vendit të ngjarjes. Kjo provë i jep padyshim fund vijës së mbrojtjes të paraqitur nga të pandehurit V.J. dhe G.Xh., të cilët pretenduan se ata e kaluan mbrëmjen në një restorant të shoqëruar nga dy femra.

Prova të tjera lidhur me pjesëmarrjen e V.J. në sulmin e 28 qershorit 2012, dolën në dritë nga përgjimi i telekomunikimeve ndërmjet V.J. dhe K.M. Gjatë kësaj bisede telefonike, V.J. i dha vëllait të tij S. informacion të detajuar në lidhje me sulmin dhe teksti i komunikatës përpilohet në telefon. Duhet theksuar se teksti i lexuar nga telefoni nga S.J. përputhet në çdo detaj me komunikatën që u publikua dikur atë ditë, duke treguar kështu se të dy vëllezërit J. punojnë së bashku në të njëjtën organizatë.

2. S.J.

A. Pjesëmarrja në një grup terrorist.

Pjesëmarrja e S.J. në “LEL” u provua nga një tërësi provash të qëndrueshme dhe bindëse.

Trupi gjykues vlerëson se një element i rëndësishëm i përfshirjes në grupin terrorist “LEL” ishte pjesëmarrja në ekspedita të tipit ushtarak, gjatë të cilave ata patën rastin unik të mësoheshin me armët e rënda. Provat e mbledhura në këtë aspekt – fotografitë – janë të pamëdyshta, sepse ato përshkruajnë S.J. dhe të pandehurit e tjerë gjatë këtyre ekspeditave. Fotografitë u sekuestruan gjatë kontrollit në vendbanimin e S. dhe V.J. më 1 korrik 2012, në aparatën fotografik digjital të sekuestruar. Të njëjtat foto u gjetën në një kompjuter personal të sekuestruar në vendbanimin e vëllezërve J. Fotografitë e gjetura në kompjuterin e vëllezërve

J. tregojnë në mënyrë të qartë se S.J. mori pjesë të paktën në katër ekspedita të tjera më 18 mars, 28 prill, 1 dhe 6 maj 2012.

Një grup fotosh tregojnë S.J., G.Xh. dhe E.M. në një pyll. Të tre janë të veshur me rroba të zeza me logot e UÇK-së në to. Fotografitë ishin ruajtur në formë digjitale me emrat të skedarëve DSC00431/DSC00441, DSC00435, DSC00431 DSC00432 dhe ishin vendosur në D / USB per Bruksel ke kam pas / Skedar i Ri në hard disk drive të kompjuterit të vëllait J., të gjetur gjatë kontrollit. Një grup tjetër fotosh të bëra në pyll më 29 prill 2012 tregon S.J. dhe G.Xh., të cilët janë duke mbajtur një Barrett M95, një armë të dytë të pa identifikuar në mënyrë të qartë dhe një të tretë së cilës mund t'i shihet vetëm qyta. Emrat e skedarëve të fotove janë DSC00477, DSC00479, DSC004780 dhe DSC004781, të ruajtur në kompjuter Lenovo s/n UMBXD5C nën D/ USB per Bruksel ke kam pas / New Folder / teli1:. Fotografi të tjera e tregojnë S.J. të ulur pranë një fuçie të madhe blu gjysmë të groposur, duke grumbulluar armë, duke i mbajtur ato dhe pastaj duke pretenduar se po merrte diçka në shenjë. Fotografitë janë quajtur Photo011 - Photo030. Ato përmenden në raportin e shërbimit të datës 29 tetor 2012 (Analizë e DVD D8) – ky raport është përfshirë në dosjen “Raportet e Policisë 6”. I njëjti raport shërbimi përmend edhe fotografitë e bëra më 1 maj 2012. Këto fotografi tregojnë S.J.; në një foto, mund të shihet fuçia blu gjysmë e groposur dhe e mbuluar me gjethe të rëna; kjo foto është quajtur DSC00485. Ka dhe një grup tjetër fotosh, të bëra gjatë ekspeditës më 6 maj 2012, që e përshkruajnë S.J. dhe E.M. në një pyll, të veshur në të zeza dhe duke mbajtur pushkë të gjata.

Brenda grupit, S.J. ishte përgjegjës edhe për hartimin e komunikimeve me publikun në lidhje me sulmin e 28 qershorit 2012. Dokumenti origjinal u gjet në vendbanimin e S.J. – ai është shënuar Public 84/12, dhe mban datën 28.06.2012; ai ndodhet në ‘Dosjen e Provave, Dosja’ nën 29 si ‘Prona e PROVAVE OCIU/CTU/2012/0013 PROVA NO. B5 E1213b17 dhoma e punës e të dyshuarit. Përgjimet telefonike tregojnë se S.J. i hartoi komunikimet pas konsultimeve me vëllain e tij V.J. Bazuar në deklaratat e dëshmitarit K.M. më 9 gusht 2012, i cili u mor në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor në 22 korrik 2013, është përtej dyshimit se V.J. i kërkoi K.M.t të mundësonte një bisedë telefonike ndërmjet V.J. dhe S.J. në mobilin e K.M.t herët në mëngjes, në orën 6:42 të datës 28 qershor 2012. Është vërtetuar përtej dyshimit se gjatë kësaj bisede telefonike V.J. e informoi S.J. për detajet e sulmit. S.J. pastaj përgatiti komunikatën e datës 28 qershor 2012, të përmendur më lart. Gjatë marrjes në pyetje më 19 shkurt 2013, S.J. pranoi se e kishte nënshkruar njoftimin që pranonte përgjegjësinë për sulmin e 28 qershorit 2012.

Prova të tjera dërrmuese që ilustrojnë përfshirjen e S.J. në lëvizjen terroriste përfshijnë dy ditarë, ditar elektronik dhe në letër, të sekuestruar gjatë kontrollit (ndarja 30 me numër reference ‘OCIU/CTU/2012/0013 prova nr. B-17 E1213b17 dhoma e punës e të dyshuarit’ në dosjen e shënuar ‘DOSJA E PROVAVE’). S.J. bën fjalë për “ne” duke iu referuar në mënyrë të qartë një grupi, në mënyrë të veçantë duke përmendur të paktën katër anëtarët: V.J., ai vetë, A.Z. dhe G.Xh., që kanë për qëllim të ndërmarrin sulme të armatosura kundër “serbëve”. Në mënyrë të veçantë, siç tregohet në aktakuzë, ditari përmban disa shënime që e vërtetojnë këtë fakt përtej dyshimit të arsyeshëm. Shënimi i parë relevant është ai i datave “Maj – qershor 2011” dhe që thotë kështu: “[...] *Pas kësaj, grupin që kemi organizuar për të*

vepruar kundër Serbisë në Preshevë gjatë këtij muaji, e quajtmë UÇKL (Ushtria Çlirimtare e Kosovës Lindore). [...] Me përfundimin e luftës në Maqedoni, ne u orientuam në organizimin e grupeve guerile në Preshevë [...]”. Shënimi i dytë relevant është ai i datës “19/01/2007, ora 21:00”. Aty thuhet si vijon: “[...] Plani ishte të sulmoheshin pikat serbe në [e paqartë], Konatoc [...] qëllimi ishte të bëheshin shqiptarët të vetëdijshëm që të mos votonin...”. Shënimi i tretë relevant është ai i datës “29/03/2008, ora 15:30” dhe ku thuhet si më poshtë: “A.Z. erdhi në banesën tonë në Prishtinë ([rruga]) më dha premtimin se do të vijë në Preshevo për të sulmuar serbët!!!”. Shënimi i katërt përkatës është ai i datës “22/10/2010”, ku thuhet si vijon: “Prishtina, unë, [...] dhe G.Xh. bëmë një grup të fshehtë që do të hyjë në Preshevë në verën e vitit 2011”. Përsëri S.J. pranoi se ishte autori i këtij ditari të shkruar, në të cilin ai paraqiste kredon politike të kësaj organizate.

Ditari në letër kishte rëndësi të veçantë; ai tregon jo vetëm përfshirjen direkte të S.J. në “LEL”, por edhe ilustron ndërmarrjet e vazhdueshme të kryera në raste të shumta nga “LEL”, për të mbledhur armë dhe si pasojë për të realizuar idetë për ta detyruar Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanovcit, duke i detyruar pjesëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të largoheshin nga vendet e tyre të punës, duke e detyruar komunitetin ndërkombëtar të vendoste forca paqeruajtëse në këtë rajon. I njëjti kërkim për armë vihet re lehtë edhe në ditarin në formë elektronike.

Një provë e rëndësishme që paraqet përfshirjen e thellë të S.J. në “LEL” është letra drejtuar autoriteteve belge me historinë e lëvizjes dhe përfshirjen S.J. në të që nga fillimi i vitit 2000.

Leximi i ditarëve dhe një letër drejtuar autoriteteve belge të çojnë në një përfundimin e mundshëm se lëvizja zhvilloi program politik radikal, kërkonte në mënyrë aktive aktivistë të motivuar politikisht, të cilët ishin të gatshëm të zbatonin programin politik duke ndërmarrë kryengritje të armatosur. Me shkallë të lartë sigurie mund të konkludohet se, në rast se nuk do të ndaleshin nga ndërhyrja e prokurorisë përkatëse në Kosovë, veprimet luftarake do të çonin në veprime reciproke ushtarake të Qeverisë së Republikës së Serbisë kundër një grupi të armatosur terrorist.

S.J. e paraqiti veten si një person tejet i motivuar publikisht. Kështu, edhe pas arrestimit të parë në lëndë më 1 korrik 2012, pasi u lirua ai e intensifikoi përfshirjen e tij në lëvizje dhe në fund mori pjesë në sulmin e datës 7 tetor 2012.

B. Kryerja e terrorizmit përmes sulmit të 7 tetorit 2012, në lidhje me S.J. dhe E.M.

Gjatë hetimit u vërtetua se më 7 tetor 2012, postblloku serb në Dobrosin u sulmua me armë zjarri; këtë herë nuk u raportuan viktima. U raportua se 15 gëzhoja të kalibrit 7.62 mm dhe 48 gëzhoja të tjera të kalibrit të panjohur u gjetën në vendin e ngjarjes të ndodhur në afërsi të fshatit Stubline, afër kufirit midis Serbisë dhe Kosovës.

Grupi kryesor i provave në këtë drejtim vjen nga përgjimi i telekomunikimeve, i urdhëruar ligjërisht. Nga telekomunikimet e përgjuara u mësua se të tre këta të pandehur biseduan me njëri-tjetrin duke përgatitur sulmin.

Për të hedhur dritë mbi rrjedhën e ngjarjeve që paraprinë sulmin, duhet të citohen thirrjet e mëposhtme telefonike të përgjuara.

Më 29/09/2012, në 01:03, G.L. thërret S.J. Ai i kërkon S.t të vijë të nesërmen pasdite sepse ai do të **“piqte një pulë”**, një të mirë që e kishte marrë. S. pranon. Më 29/09/2012, në orën 20:11, S. thërret G.L., i cili ankohet se S. nuk shkoi; S. thotë se ai nuk mundet, G.L. përgjigjet se “ai nuk do të ketë aso lloj shansesh çdo ditë”. Më 30/09/2012, në orën 11:54, S.J. thërret E.M. dhe i thotë se **ata nuk duhet të flasin shumë në telefon**. E.M. do ta vizitojë atë në banesën e tij. Më 05/10/2012, në orën 12:56, E.M. thërret S.J. dhe e pyet se ku është; S. do të shkojë te G.L. me autobus dhe e pyet E.M. nëse ai mund të bashkohet me ta, por ky i fundit nuk pranon. S. do të **“hajë pulë”**. Më 05/10/2012, në orën 16:52, S.J. thërret G.L. dhe i tregon se ai do të jetë në Gjilan për gjysmë ore, G.Xh. duhet ta ketë pulën gati për të; G.Xh. pajtohet. Në datën 5/10/2012, në orën 17:43, S. thërret G.Xh. për t’i treguar se ai është në stacion. Më 6/10/2012, në orën 20:14, E.M. thërret S.J. dhe e pyet nëse ai ka **ngrënë ndonjë pulë**; S. i thotë jo tamam; pastaj ai i kërkon E.M.t ta takojë të nesërmen në orën 2/2:30 dhe të mos flasë në telefon; E.M. është i zënë, por në qoftë se i duhet të jetë atje, ai do të jetë. Më 07/10/2012, në orën 14:08, S.J. thërret G.L. për t’i kërkuar të gjejë një makinë, sepse ata do të shkojnë në Ferizaj më vonë; G.Xh. pajtohet.

Trupit gjykues nuk i mbeti asnjë dyshim se të pandehurit e angazhuar në këtë bisedë në fakt po bënin përgatitjet për sulmin që ndodhi pikërisht të nesërmen. Kjo pseudo gjuhë e koduar nuk e mashtroi trupin gjykues se të pandehurit po flisnin vërtet për pula dhe konsumin e këtyre zogjve të shijshëm, por në fakt me pulë ata e kishin fjalën për armë.

Prania e këtyre dy të pandehurve në vendin e ngjarjes është provuar si duhet nga antenat GSM të vendosura në zonën në fjalë.

Më 07/10/2012, në orën 23:27, S.J. i dërgon G.L. këtë SMS “në qoftë se don të qish, eja tani, unë jam tek vendi”. Mobili i S.J., [nr.], aktivizon (a) qelizën “capari_2” në orën 21:08, dy herë në orën 21:09, në orën 21:23, në orën 21:38, dhe më pas dymbëdhjetë herë nga ora 22:00 deri në orën 23:15; dhe (b) qelizën “Pograxha_3” nëntë herë nga ora 23:20 deri në orën 23:30. Të dy qelizat mbulojnë zonat e ndodhura në afërsi të Stublines. Mobili i E.M., [numrin e telefonit], aktivizon qelizat “capari_2” (dy herë në orën 17:51), “Pograxha_1” (dy herë në orën 19:49), dhe “capari_2” (4 herë në orën 20:14).

Nuk ka asnjë shpjegim tjetër pse këta të pandehur ishin të pranishëm në këtë zonë, në atë kohë të veçantë, përveç sepse ata morën pjesë në sulmin e armatosur.

Prova të tjera në lidhje me këtë sulm të veçantë dalin nga dëshmia e S.J. dhënë gjatë marrjes në pyetje. Kur u mor në pyetje më 16 tetor 2012, S.J. pranoi se nënshkroi marrjen përsipër të përgjegjësisë si G.S. Ai pranoi gjithashtu se kjo marrje përsipër e përgjegjësisë u publikua në internet duke përdorur adresën e tij të e-mail-it.

E.M. pretendoi se në ditën kritike të 7 tetorit 2012, nga ora 07:00 deri në orën 23:00 ai po priste dru në pyllin pranë fshatit të tij me disa anëtarë të tjerë të familjes. Ai mohoi të kishte qenë në zonën e sulmit, domethënë, në fshatin Stubline në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë. Po kështu, ai konfirmoi se në kohën e sulmit përdorte [numrin e telefonit]. Dëshmia e E.M. nuk u konsiderua e besueshme, pasi i pandehuri donte t'i shmangej përgjegjësisë penale për veprat penale me të cilat është i akuzuar. Dëshmia e tij mbetet në kundërshtim me provat e besueshme të mbledhura nga PSRK, në veçanti telekomunikimet e përgjuara dhe qelizat GSM që përcaktuan vendndodhjen e dy të pandehurve më 7 tetor në zonën afër vendit nga i cili ata kryen sulmin.

3. G.L., akuzat penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në një grup terrorist.

U provua përtej dyshimit të arsyeshëm se G.L. ishte anëtar aktiv i grupit terrorist “LEL”, sepse kryente funksione të rëndësishme brenda grupit, duke marrë pjesë në aktivitetet e tij, në veçanti duke siguruar armët nga kjo organizatë.

Faktet lidhur me përgjegjësinë penale të tij u vërtetuan në bazë të dëshmive të mbledhura gjatë hetimit, kryesisht përgjimet e telekomunikimit dhe ditari elektronik i S.J.

Përgjimet telefonike ndërmjet G.L. dhe V.J. provuan se G.L. ishte anëtar i grupit dhe u angazhua në realizimin e qëllimeve të përbashkëta të grupit duke marrë pjesë në blerjen e armëve për Lëvizjen.

Një bisedë telefonike e rëndësishme mban datën 10 qershor 2012, ora 16:46. Ky përgjim telefonik, ashtu si përgjimet telefonike të tjera, të përmendura në këtë Aktgjykim, u dëgjua përsëri gjatë shqyrtimit gjyqësor më 26 dhe 27 qershor 2013, dhe regjistrimet në CD, si dhe transkriptet dhe përkthimet janë përfshirë në shkresat e lëndës. V.J. thërret G.L., i cili i tregon atij se një person “ka një pulë të rëndë me 30 zogj dhe kushton 300”. V.J. përgjigjet se ai nuk ka para, por i thotë *“kontrolloje në fillim nëse punon apo jo.”*

Pjesëmarrësit në bisedë, si në shumë të tjera, përdornin gjuhë të koduar të zhvilluar nga të pandehurit me qëllim të kësaj ndërmarrjeje kriminale, për të fshehur kuptimin e vërtetë të bisedave. Ky pretendim është i bazuar mirë dhe mbështetet në prova të forta. Kjo dëshmohet me faktin se, pas arrestimit dhe kontrollit personal, në xhepin e Q.R. u gjet një listë e fjalëve të kodit, sipas të cilit dy fjalë që përmenden shpesh në përgjime, d.m.th. “pulë” dhe “zogj” do të thonë “Kallashnikov” dhe “Municione” përkatësisht. Kjo është në përputhje me faktin se bisedat marrin kuptim vetëm nëse deshifrohen përshtatshëm.

Përpjekjet e dëshpëruara të mbrojtjes për të provuar se në fakt të pandehurit po bisedonin për ngritjen e një fabrike bujqësore të shpendëve (duke marrë parasysh shumën e konsiderueshme të parave kinse të investuara) ose zbukurimin e veturave me pamje të zogjve të vegjël, është vlerësuar si përpjekje e pakuptimtë për të shmangur përgjegjësinë penale. Asnjë provë tjetër nuk u paraqit se të pandehurit duan të ndërtojnë një fabrikë shpendësh, përveç disa fotove të një pule me zogj të vegjël dhe një veturë të zbukuruar me letër me pamje të pulave. Të gjitha

provat vërtetohen me paraqitjen e bazuar mirë të bërë nga prokuroria se interesimi kryesor i kësaj organizate ishte blerja e armëve për të realizuar qëllime politike.

Duke zbatuar planin e “LEL”, G.L. e informon V.J. në lidhje me mundësinë për të blerë një armë, një ‘Kallashnikov’, shkurt AK47, me 30 fishekë për 300 euro. G.L. bleu edhe pajisje të tjera të nevojshme nga grupi për aktivitetet e tij. Më 15 qershor 2012, në orën 22:59, pra më pak se dy ditë para sulmit të parë, G.L. thërriti V.J. për “Një palë sy që mund t’i shohësh natën, prandaj mund t’i huazosh”. V.J. i përgjigjet: “Në rregull është. Do të të njoftoj një ditë përpara”. Nga ana tjetër, gjatë shqyrtimit gjyqësor G.L. u mbrojt në mënyrë të përsëritur se në atë bisedë ai e kishte pasur fjalën vërtet për syze të zakonshme leximi. Është e qartë se kjo është vetëm një përpjekje këmbëngulëse për të justifikuar sjelljen e tij, dhe nuk jep asnjë shpjegim të arsyeshëm për ato që përmendi ai. Është e qartë se termi “palë sy që mund të shohësh natën”, në të vërtetë u referohet syzeve me shikim natën, që përdoren nga ushtria.

Pjesëmarrja e G.L. në grup dhe aktivitetet e tij në fushën e sigurimit të armëve dëshmohet po ashtu në shënimet e ditarit elektronik të S.J. Ditari elektronik është gjetur në vendbanimin e vëllait të J. siç është paraqitur detajisht në raportin e punës të datës 26/09/2012 – ditari në kompjuterin e V.J./S.J.

Në ditar, është një shënim i datës 24 shkurt 2012 ku S.J. i referohet një bisede që ka pasur me G.L. në Facebook, gjatë bisedës G.L. i ka thënë S.J. se “ai ka një pushkë mitraloz 84 me 500 fishekë me zinxhir” me çmim prej 500 Eurosh. Më 28 shkurt 2012 G.L. i ka thënë S.J. gjatë bisedës në Facebook “të shkojë nesër në Gjilan për të marrë një zinxhir për 84”. Të dy bisedat qartësisht i referohen blerjes së Zastava M84 prodhim Jugosllav, një PK prodhim rus, ose një M80 prodhim kinez, një mitraloz për përdorim të përgjithshëm dhe fishkë për të të kalibrit. Lloji i armës është identifikuar gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më 24 korrik 2013 nga dëshmitari ekspert F.L. i cili ka konfirmuar se fotot SAM_0053 – SAM_0085 dhe për shembull në veçanti fotografia SAM_0056 e ruajtur në C:/Doc & Settings/User/Desktop/00000 sipas ditarit të punës të datës 29 tetor 2012 (Analizë e DVD D8) tregon një mitraloz të tillë që mbahet nga S. Mendimi i këtij eksperti është konsideruar si i besueshëm meqë është përgatitur dhe prezantuar nga një profesionist që ka njohuri gjithëpërfshirëse në fushën e armatimit.

Angazhimi i plotë i G.L. në aktivitetet e “LEL” reflektohet në njërin nga përgjimet e datës 28 qershor 2012 në orën 14:45 disa orë pas sulmit të dytë në Stacionin e Policisë në Dobrosin, G.L. ka thirrur V.J. duke u ankuar që nuk ka marrë pjesë në këtë sulm një natë më herët dhe ka pyetur nëse ishte lënduar ndokush nga grupi. Trupi gjykues vëren se ky i pandehur ka qenë aq i përfshirë në zbatimin e strategjisë ushtarake të “LEL” sa që atij seriozisht i vinte keq që nuk kishte marrë pjesë në njërin nga sulmet ushtarake.

Për më shumë, ekzistojnë prova të mjaftueshme se G.L. ka marrë pjesë në një ekspeditë të llojit ushtarak më 14-15 qershor 2012.

Në tërësi, të gjitha provat e mbledhura qartësisht kanë treguar që G.L. ka kontribuar në nivel domethënës në zhvillimin e kësaj lëvizjeje duke marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e tij duke siguruar armë dhe duke e vënë veten në dispozicion të këtij grupi terrorist.

4. A.Z. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se A.Z. ka qenë anëtar aktiv i grupit terrorist "LEL". A.Z. ka qenë në kontakt të ngushtë me V.J. dhe S.J., prej 01 januar 2012 deri më 01 korrik 2012, janë përgjuar 111 thirrje telefonike në mes të A.Z. dhe V.J. dhe S.J. Numri i bisedave qartësisht tregon intensitetin e raporteve. Për më shumë, ekzistojnë dëshmi të forta se A.Z. ka marrë pjesë në dy ekspedita të tipit ushtarak më mes të majit dhe në mes të qershorit të vitit 2012.

Për më shumë, është dëshmuar përmes telekomunikimeve të përgjuara se A.Z. ka marrë pjesë edhe në një mision si pjesëtar i Lëvizjes. Ai ka marrë pjesë në një aktivitet zbulimi/vëzhgimi së bashku me S.J. më 17-18 qershor 2012. Më 17 qershor 2012 nga 16:09h deri më 16:44h janë regjistruar një seri kontaktesh në mes të V.J., M.A. "M." dhe A.Z. V.J. thotë "*bëhu gati për atë që e di*". M.A. i thotë V.J. të thërrasë vetëm "Ma." V.J. pastaj thërret A.Z., i cili është saktësisht nga Ma., por ai të nesërmen ka provim. Më 18 qershor 2012 në 19:03h G.Xh. thërret V.J., V.J. i thotë se "*nesër "S." dhe "A." do të shkojnë dhe të vëzhgojnë nëse atje diçka lëviz në mënyrë që mos të shkojmë atje dhe të qëndrojmë kot*". Të njëjtën ditë V.J. thërret Q.R. dhe e informon që janë dy që e patrollojnë një vend të caktuar të shohin "*nëse po kalojnë*". Q.R. kërkon nga V.J. t'u thotë atyre "*rregulloni ato gjëra duke u kthyer*". V.J. e informon që janë "S.", i referohet S.J., dhe "A." dhe prandaj ata mund të rregullojnë gjërat më mirë. Ai shton "*ata janë këtu afër Gjilanit*". Nga këto komunikime të përgjuara dhe kontekstit të përgjithshëm është e qartë se A.Z. së bashku me S.J. kanë marrë pjesë në mision zbulimi/vëzhgimi të stilit ushtarak në kufi me Serbinë me qëllim që të sigurojnë informacione mbi lëvizjen e policisë kufitare serbe në zonë.

Anëtarësimi i A.Z. në grup po ashtu është konfirmuar përmes fotos së gjetur edhe në aparat fotografik e edhe në kompjuterin personal të konfiskuar në vendin ku jeton S.J. ku shihet A.Z. i veshur në uniformë turke me një revole të ngjeshur në rrip. Fotografia është bërë brenda vendbanimit të V.J. dhe S.J. më 06 maj 2012, duke u referuar Raportit të punës së datës 29/10/2012, Analizë e DVD D8.

Në aparatin fotografik dixhital të konfiskuar në vendbanimin e S.J. dhe V.J. më 01 korrik 2012 ka po ashtu foto që tregojnë A.Z. dhe S.J. diku në pyll në dy raste të mëhershme. Në disa foto të bëra më 08 maj 2012, S.J. dhe A.Z. shihen, të dy duke mbajtur AK-47 me "UÇPMB" të gdhendur në qytën e drurit. Fotot e tjera të bëra më datën 20 maj 2012 prapë tregojnë S.J. dhe A.Z. Po ashtu, ky i fundit është i fotografuar duke qëndruar në këmbë në një pemë duke bërë shenjën "OK" drejt aparatit fotografik.

Anëtarësimi i A.Z. në grup po ashtu është vërtetuar përmes faktit që ai ka qenë në dijeni për vendndodhjen e depos së armëve të grupit që më janë ishin vjedhur. Fakti që ai ka qenë në dijeni për vendndodhjen e deposë së armëve është vërtetuar përmes përgjimeve të komunikimeve nga data 30 qershor 2012 në orën 11:36. Në këtë bisedë V.J. thërret Q.R., i cili thotë se ka biseduar me "A.", ku i referohet A.Z. dhe ka mësuar se gjërat që janë marrë, i është bërë referencë depos së armëve.

Po ashtu është vërtetuar se A.Z. ka pasur dijeni të dorës së parë për vendndodhjen e armëve të grupit sepse në telefonin e A.Z. hetuesit kanë gjetur tre foto të bëra nga afër të një predhe që gjendej në tokë. Fotografitë janë bërë më 26 prill 2012 në një zonë të pyllëzuar. Referencë i është bërë raportit të punës të datës 23 janar 2013 “Analizë e përmbajtjes së DVD telefonit mobil + disqeve floppy + kartelave memorie/memory cards”.

Është edhe një provë tjetër e qartë të përfshirjes serioze të A.Z. në “LEL” që është një shënim i shkruar me dorë në ditarin e S.J. që sugjeron se bashkëpunimi i A.Z. me V.J. dhe S.J. dhe grupin daton prej shumë më herët. Një shënim i datës 29 mars 2008 në orën 15:30 thotë si në vijim: “A.Z. ka ardhur në apartamentin tonë në Prishtinë ([rruga]) më ka premtuar se do të vijë në Preshevë për të sulmuar serbët!!!”. Në ditar po ashtu shkruan: “2003-2004 Gjatë periudhës tonë në Kosovë, unë dhe V.J. jemi munduar të krijojmë grupe. [...] Anëtarë kanë qenë [...] A.Z. [...] etj.”

Të gjitha provat e mbledhura kundër A.Z. të shqyrtuara ndaras dhe së bashku janë dëshmi e fortë se edhe ky i pandehur po ashtu kanë marrë pjesë në grup terrorist.

5. E.M. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Bazuar më provat e mbledhura është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se E.M. ka qenë anëtar aktiv i grupit terrorist “LEL” dhe ka kryer akt të terrorizmit.

E.M. ka ndihmuar grupin në kërkimin e tij të vazhdueshëm për armatim. Në kompjuterin personal të V.J. dhe S.J. është gjetur shënimi si në vijim i datës 04 mars 2012: “*E mërkurë, G.Xh., E.M., një djalë nga ana e C. dhe 3 djem të tjerë nga ana e P. (mbiemri i njërit nga ata është R.; babai i tij është hero) dhe unë kemi shkuar te G për armë ...*”, [...] “*në fund e kam lenë të flasë me E.M. në mënyrë që t’i tregojë diçka më shumë*”.

E.M. ka dëshmuar se ka qenë anëtar i devotshëm i “LEL” i cili ka marrë rol aktiv në dy sulme terroriste të bëra kundër Policisë Kufitare Serbe më 28 qershor dhe 7 tetor 2012. Veprimet e tij lidhur me këto sulme janë argumentuar në pjesë të tjera korresponduese të këtij arsyetimi.

E.M. ka qenë në kontakt të ngushtë me V.J. më parë dhe lidhur me sulmet. Më 05 qershor 2012 në orën 16:16 G.Xh. thërret V.J. dhe i thotë që “V.” (pseudonimi i E.M.) nuk mund të vijë. V.J. përgjigjet “*Eja vetëm dhe “V.” [d.m.th. E.M.]mund të pushojë këtë herë*”. Kjo bisedë tregon që plani fillestar ka qenë që E.M. të marrë pjesë në sulm. Komunikimi i radhës i rëndësishëm ka ndodhur më 13 qershor 2012 në orën 12:35. V.J. thërret E.M. V.J. prapë kërkon G.Xh., ai ka menduar që “V.” dhe G.Xh. punojnë në të njëjtin vend por “V.” [d.m.th. E.M.]thotë që ata kanë përfunduar te G.Xh. Më datën 15 qershor 2012 në orën 14:10 E.M. ka dërguar një SMS te V.J. dhe pyet “*Si ishte dje?*” Ekspedita e grupit në zonën e Gjilanit ka ndodhur pikërisht më datën 14-15 qershor 2012. Më 15 qershor 2012 në orën 16:27 E.M. thërret V.J. Këto biseda dëshmojnë se E.M. ka qenë pjesëtar i grupit që ka qenë ngushtë i përfshirë në planifikimin e ekspeditës dhe i interesuar në rezultatin.

Trupit gjykues nuk i ka ikur nga vëmendja që E.M. ka marrë pjesë në dy ekspedita shtesë të “LEL”, më 18 mars dhe 6 maj 2012. Sipas Trupit gjykues këto ekspedita ushtarake kanë pasur për qëllim përmirësimin e kapaciteteve ushtarake të grupit duke e përgatitur për sulme terroriste kundër qeverisë së Republikës së Serbisë.

Kjo dëshmohet përmes fotografive të gjetura në kompjuterin personal të konfiskuar në vendbanimin e S.J. dhe V.J. më 01 korrik 2012. Ekziston një seri fotografish të bëra në mes të orës 15:53 dhe 18:43 më 18 mars 2012 që tregojnë S.J., G.Xh. dhe E.M. në pyll. Të tre meshkujt janë të veshur në rroba të zeza me shenja të UÇK-së në to. Është e qartë nga Q.R. i trupit i G.Xh. dhe E.M. se ata po përgatiteshin të hapnin një gropë.

Ekspedita e fundit e përmendur, ajo e 6 majit 2012, përmendet në Komunikatën e “LEL” për një sulm tjetër që supozohet se ka ndodhur saktësisht më 6 maj 2012 në orën 02:54, dhe ultimatumit i datës 05 maj 2012. Ishte bërë një seri fotografish në mes të orës 03:54 dhe 5:49 më 06 maj 2012 ku shihen S.J. dhe E.M. në pyll, të dy të veshur në të zeza dhe të dy mbajnë pushkë të gjata. Përderisa nuk ekzistojnë prova të dokumentuara se ky veprim në fakt ka ndodhur, fotografitë ku shihen S.J. dhe E.M. në pyll, të armatosur dhe në uniformë, dhe fotografia e gjurit të mavijosur që mban datën dhe orën e njëjtë, sugjeron se këta të dy kanë qenë në pyll atë natë të gatshëm të kryejnë sulmin e përmendur në komunikatën e datës 06 maj 2012’. Duhet të theksohet se sulmi i pretenduar i 6 majit 2012 nuk është marrë parasysh nga pikat e akuzave në aktakuzë.

Afërsia e ngushtë e E.M. me V.J. dhe S.J. dhe grupin po ashtu është dëshmuar me faktin se munduar vazhdimisht të kontaktojnë V.J. pas arrestimit të tij më 01 korrik 2012. E.M. në mënyrë të vazhdueshme është munduar të kontaktojë atë në mobil; dhjetë herë më 01 korrik 2012 në mes të orës 18:47 dhe 22:58, dhe dy herë më 02 korrik 2012 në mes të orës 11:38 dhe 15:24.

6. G.Xh. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Provat e mbledhura në dosjen e lëndës dëshmuar se G.Xh. ka qenë pjesëtar aktiv i grupit dhe se ai ka kryer funksione të rëndësishme brenda grupit.

G.Xh. ka qenë në kontakt të ngushtë telefonik me V.J. deri në momentin kur ata të dy janë arrestuar më datën 01 korrik 2012. Nga data 01 janar deri më 01 korrik 2012, janë dokumentuar 437 thirrje telefonike hyrëse dhe dalëse në mes të G.Xh. dhe telefonit të përdorur nga V.J. dhe S.J. Bisedat telefonike tregojnë se G.Xh. ka pasur rol të rëndësishëm brenda lëvizjes. Ky numër enorm i bisedave telefonike në krahasim me përmbajtjen e tyre tregojnë natyrën e raportit në mes të G.Xh. dhe vëllezërve J.

Përmes ilustrimit, në “raportin e tij të parë 15 ditësh” të datës 21 qershor 2012, hetuesi CTU Mitrano raporton që G.Xh. ka informuar V.J. me telefon më 04 qershor 2012 lidhur me një “Gjysëm automatik të prodhimit kinez” për çmim prej 330 Euro që “kur ngreh këmbëzën ka një pozitë që [...] do të shpërthejë në automatik si 10-shi (përkthim i lirë; ju lutem shihni

originalin-shënim i përkthyesit).”Në përgjigje të pyetjes së V.J. “A mund të shohësh karikatorin?” G.Xh. është përgjigjur që “*duket njësoj si 30-shi, si ato të Serbisë*”, kjo bisedë qartësisht i referohet sigurimit të armëve dhe dëshmon që G.Xh. ka ndihmuar në blerjen e armëve për grupin.

Siç është paraqitur detajisht në “raportin e parë 15-ditësh” të datës 21 qershor 2012, më datën 07 qershor 2012 G.Xh. dhe V.J. kanë pasur disa telefonata lidhur me blerjen e së paku 6 apo 7 uniformave gjermane për grupin. Më 18 qershor 2012 në orën 19:03 G.Xh. thërret V.J., ata diskutojnë lidhur me aktivitetet vëzhgim/zbulim që do të kryheshin. V.J. i thotë G.Xh. se “*nesër “S.” dhe “A.” do të shkojnë dhe të vëzhgojnë nëse atje diçka lëviz në mënyrë që mos të shkojmë atje dhe të qëndrojmë kot*”; ai shton: “*nuk do të shkojmë me tomahokë në duar*”. Kjo bisedë tregon se G.Xh. dhe V.J. po diskutojnë strategjinë e grupeve në raport me përgatitjen dhe ndërmarrjen e sulmeve të armatosura.

Më 27 qershor 2012 në orën 19:40, disa orë përpara ndërmarrjes së sulmit të dytë në Dobrosin, V.J. thërret G.Xh., duke kërkuar mendimin e tij lidhur me huazimin e “*makinës së “V.”*” (makinës së E.M.). G.Xh. pret që E.M. të vëjë makinën e tij në dispozicion dhe V.J. thotë “*po qofte se e ka pushim shkojmë sonte edhe kthehem, dy ore krejt këna pune atje veq mi qit ne kerr 3 copa pe din ti edhe mi qit anej te ajo qeshmja aty, a pe di.*” Kjo tregon se G.Xh. dhe V.J. kanë punuar së bashku në dobi të grupit për të organizuar transportin e anëtarëve të grupit kur kanë kryer aktivitetet lidhur me grupin në zonën kufitare. Më 29 qershor 2012 në orën 16:30 është bërë një thirrje telefonike në mes të V.J. dhe G.Xh. gjatë së cilës V.J. ofron të dërgojë “*S.*”, referencë i bëhet S.J., nëse G.Xh. ka nevojë të groposë diçka sepse këtij të fundit i dhemb dora. Kjo bisedë telefonike i referohet faktit që grupi ka mbajtur depon e armëve dhe municionit të groposur nën tokë dhe gjethe në fuçi plastike të kaltra.

Anëtarësimi i G.Xh. në grup po ashtu dëshmohet përmes një fotografie me emër të skedarit SAM_0015, të gjetur edhe nga aparati fotografik edhe nga kompjuteri personal i konfiskuar në adresën e V.J. dhe S.J. ku shihet G.Xh. duke mbajtur një revole. Fotografia është bërë brenda në apartamentin e V.J. dhe S.J. më 6 maj 2012. Fakti që fotografia është bërë në adresën e V.J. dhe S.J. është vërtetuar përmes ekzaminimit të të pandehurit S.J. më 03 korrik 2012, pyetja 3: “*PP: Z. J., ju lutem shikoni këtë fotografi dhe më thoni nëse njihni dikë. [...] S.J.: Ky është G.Xh. Duke shikuar orenditë, mendoj se fotografia është bërë në apartamentin tim në Prishtinë. Nuk kam qenë i pranishëm në momentin kur është bërë fotografia. Nuk e njoh pistoletën që G. [m.b.th. G.Xh.] mban në dorë.*”

Shënimet në ditarin e shkruar me dorë të S.J. konfirmojnë se G.Xh. ka qenë i përfshirë në sigurimin e armëve për grupin; një shënim i datës 10 maj 2008 thotë si në vijim: “*Kemi dhënë 100 për të blerë një Beretta dhe 120 të tjera të shtuara nga G.Xh. i cili ka blerë një optic sigma*”. Anëtarësimi i G.Xh. në grup po ashtu është dëshmuar nga shënimi në vijim i datës 22 tetor 2010: *Prishtinë. Unë [...] dhe G.Xh. kemi krijuar një grup sekret që do të hyjë në Preshevë] në verën e vitit 2011*”.

Ditari elektronik i gjetur në kompjuterin personal të V.J. dhe S.J. po ashtu i referohet G.Xh. Një shënim i datës 20 shkurt 2012 thotë: “*Prishtinë, Facebook. Kam biseduar me G.Xh. rreth*

84 fishekë, shtojcat optike dhe zinxhirët si dhe për një 100.” Një shënim i datës 29 shkurt 2012 thotë: “E enjte, Gjilan, pasdite 14:30- 15:20h. Unë, G.Xh. dhe G.L. në Gjilan. V.J. kishte kërkuar nga G.L. disa zinxhirë për 84. G.L. ka thënë se ai kishte “një PKT, me një fuçi fishekësh, pastaj një 84 të ndryshkur, një sasi të madhe minash”. [...] “G.Xh. tha se ishte njëri që shiste një mitraloz dhe dikush tjetër nga Lipjani që po shiste dy snajperë.” Një shënim tjetër i datës 04 mars 2012 thotë: “E mërkurë, Grejkovc. G.Xh., E.M., një djalë nga ana e C. dhe 3 djem të tjerë nga ana e P. (mbiemri i njërit nga ata është R.; babai i tij është hero) dhe unë kemi shkuar te G për armë...”, “në fund e kam lënë të bisedojë me E.M. në mënyrë që ai t’i tregojë diçka më shumë”. Një shënim tjetër i datës 27 prill 2012 thotë: “E premte, Ferizaj. G.Xh., Q.R. [...]: duke kërkuar municione.” Të gjitha këto shënime në ditarin elektronik në kompjuterin personal të V.J. dhe S.J. dëshmuar se G.Xh. me të vërtetë ka qenë pjesëtar i i grupit dhe jo vetë njohur i V.J. dhe i përfshirë në sigurimin e armëve për grupin gjatë një periudhe të gjatë kohore.

Po ashtu është dëshmuar se G.Xh. ka marrë pjesë në zbatimin e qëllimeve të misionit përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e grupit në zonën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë sepse G.Xh. ka marrë pjesë në ekspeditë në pyje me E.M. dhe S.J. më 18 mars 2012, kjo, siç është shpjeguar më parë është evidentuar përmes një serie fotografish të bëra në mes të orës 15:53 dhe 18:43 më datën 18 mars 2012 që tregojnë S.J., G.Xh. dhe E.M. në pyll ku të tre meshkujt janë në rroba të zeza me logo të UÇK-së. Nga Q.R. i trupit i G.Xh. dhe E.M. në njërin nga fotot duket se ata po përgatiteshin të hapin një gropë. Siç është përshkruar në detaje më parë, tre fotot e bëra në pyll më 29 prill 2012 tregojnë S.J. dhe G.Xh. duke vringëlluar një Barrett M95, një armë të dytë që nuk është identifikuar qartësisht dhe një armë të tretë të cilës i shihet vetëm pjesa e fundit e tytës.

G.Xh. po ashtu ka marrë pjesë në dy ekspedita të llojit ushtarak me anëtarët e tjerë të “LEL” V.J., S.J., Q.R., M.A., S.S., A.Z. dhe G.L. më 15 maj dhe 14/15 qershor 2012, si është përshkruar më lart tashmë.

Anëtarësimi i G.Xh. në grup po ashtu është dëshmuar përmes faktit, siç është shpjeguar më lart, që ai është parë së bashku me V.J. dhe E.M. në ditën kur ai ka marrë pjesë në sulmin e Lëvizjes të kryer më 28 qershor 2012.

7. Q.R. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Q.R. ka qenë pjesëtar aktiv i grupit terrorist “LEL” dhe bashkëpunëtor i ngushtë i V.J.

Q.R. ka marrë pjesë në ekspeditën e bërë gjatë natës në mes të 7 dhe 8 qershor 2012 së bashku me V.J. Kjo ekspeditë është bërë për të lëvizur një objekt të paidentifikuar në dobi të grupit. Kjo dëshmohet përmes bisedave telefonike në mes të ketyre dyve. Më 06 qershor 2012 në orën 12:12 V.J. ka marrë një telefonatë nga Q.R.; V.J. i thotë të gjejë “një lloj këpucë me të cilat mund të ecësh”; më 06 qershor 2012 në 16:44h V.J. thërret Q.R. dhe e pyet nëse

“G. [d.m.th. G.Xh.]” kishte thirrur Q.R.; pastaj e informon Q.R. se “*sot nuk kanë mundur të sjellin mitralozin*”. Më 07 qershor 2012 nga ora 12:26 deri 13:06 ekziston një shkëmbim i telefonatave lidhur me uniforma gjermane. V.J. kërkon nga G.Xh. të thërrasë Q.R. dhe shton “*do të ndahemi në grupe dhe do të vendosim në cilin drejtim të shkojmë*”. Uniforma gjermane nuk është në dispozicion prandaj V.J. thotë “*ok këtë herë do të shkojmë kështu por mbani mend se nuk guxon të diskutoni këtë i thuani edhe Q.R.*”. Nga këto biseda është e qartë se në disa raste të pandehurit kanë lënë anash gjuhën e tyre të koduar dhe janë shprehur lirshëm.

Më 08 qershor 2012 në mes të natës, në 04:02h, V.J. thërret Q.R.: Q.R. thotë se “*po vij në poshtë*”. V.J. i thotë Q.R. “*mundohu t’i zhvendosësh ato gjëra*”. Q.R. përgjigjet se janë shumë të lodhur. Më 08 qershor 2012 në 15:33h një person i panjohur thërret V.J.; V.J. thotë se “*mbrëmë*” ata humbën dhe kanë qëndruar në pyll deri në mëngjes. Më 08 qershor 2012 në 20:23h V.J. thërret Q.R.; Q.R. thotë se “*është mirë të ndërrohet vendi për të zhvendosur gjërat*” dhe V.J. pajtohet. Q.R. shton “*Kisha ardhur por më është kujtuar diçka. Mendova të marr një nga ato 12.5-at këtu, t’a pastroj mirë dhe t’a provoj 2 apo 3 herë, të shoh nëse më shtynë supin dhe të shoh nëse mund ta mbaj. Po ashtu duhet të gjejmë një dylbi për të.*” V.J. vazhdon: “*Do të shkojmë një ditë kur je më i lirë, do t’i pastrojmë dhe do t’ua ndërrojmë vendin.*” Në këtë Q.R. u përgjigj “*Po, po, definitivit duhet t’ua ndërrojmë vendin; duhet të groposim vendin më thellë*”. Përderisa është e paqartë se për çfarë objekti e kishin fjalën V.J. dhe Q.R., ka gjasa të mëdha se, bazuar në faktet e dëshmuara dhe arsyetim të logjikshëm, ata e kishin fjalën për zhvendosje të armëve, ndoshta një mitraloz, meqë paraprakisht kanë qenë në kontakt dhe kanë diskutuar çështjen e sigurimit të armëve. Edhe një çështje tjetër është e shumë e qartë, tema e këtyre bisedave nuk kanë qenë pulat.

Q.R. po ashtu ka qenë i përfshirë në veprimet e grupit që kanë shërbyer si përgatitje të sulmeve të përshekruara më lart dhe kjo shihet nga biseda telefonike e 13 qershorit 2012. Më 13 qershor 2012 në 21:50h Q.R. ka thirrur V.J. V.J. thotë “*Jemi 8-9*”. Shumë, por ai shton se herën tjetër do të ketë vend edhe për kushëririn e Q.R.; V.J. qartëson se “*kjo punë*” nuk është e përshtatshme për të dhe “*ajo gjë nuk është shumë e përshtatshme është shumë e rëndë të mbahet në dorë.*” V.J. shton “*kupton çfarë po them*” dhe Q.R. konfirmon duke thënë “*Po*”. Prapë Trupi gjykues konkludon se tema e kësaj bisede nuk janë shpezët shtëpiakë, por armatimi i rëndë.

Fakti që Q.R. është munduar të angazhojë kushëririn e tij në aktivitetet e grupit tregon për një përfshirje te nivelit të lartë të Q.R. në grup. Gatishmëria e Q.R. për të marrë pjesë në aktivitetet e grupit dëshmohej po ashtu edhe me bisedat telefonike nga data 18, 28 dhe 29 qershor 2012.

Më 18 qershor 2012 V.J. thërret Q.R. dhe e informon se janë dy persona që po patrollojnë një vend të caktuar për të parë “*nëse po kalojnë ata*”. Të nesërmen do të shkojnë edhe dy të tjerë dhe ditën tjetër mund të shkojnë V.J. dhe Q.R. Q.R. pyet nëse kanë parë diçka, por V.J. nuk ka përgjigje. Q.R. kërkon nga V.J. t’u thotë të “*rregullojnë ato gjëra gjatë kthimit*”. V.J. e informon se janë “*S.*” dhe “*A.*” dhe prandaj ata mund të rregullojnë gjërat më mirë. Ai shton “*ata janë këtu afër Gjilanit*”. Q.R. thotë “*nëse ti do, unë mund të vij*”. Më 28 qershor 2012

në 12:30h në mëngjes pas sulmit të dytë, Q.R. thërret V.J., për t'u ankuar përse nuk ishte thirrur. Q.R. shpjegon se do të kishte ardhur me autobus "si gjithmonë", V.J. thotë "*Mos u merakos tjetri është shumë afër mos bisedo në telefon*", "jo më gjatë se 2/3 ditë", "G.Xh. do të tregojë më shumë për këtë." Më 29 qershor 2012 në 11:32h V.J. thërret Q.R. dhe Q.R. është ende i ofenduar; V.J. thotë se është faji i G.Xh.; Q.R. dëshiron të dijë nëse kishte plane të tjera; V.J. thotë se "*shumë shpejt*" dhe ai do t'a thërrasë prapa.

Këto biseda janë të rëndësishme specifike meqë tregojnë zotimin e thellë të Q.R. drejt qëllimeve të "LEL", gatishmërinë e tij për të marrë pjesë në sulm terrorist dhe ai madje është ndier i ofenduar që nuk ka marrë pjesë në njërin nga sulmet. Devotshmëria dhe zotimi i këtij të pandehuri dëshmohet përmes faktit që Q.R. i kishte besuar Lëvizjes Kallashnikovin e tij personal, kujtim nga lufta nga axha/daja i tij.

Q.R. ka qenë në dijeni për vendin se ku e ka mbajtur grupi Kallashnikovin e tij së bashku me armët e tjera, Q.R. po ashtu e ka ditur se çfarë armësh të tjera janë ruajtur në atë vend. Q.R. po ashtu e ka ditur se ku gjendet vendi tjetër ku janë mbajtur më shumë nga armët e tjera të grupit sepse i ka ndihmuar grupit t'i vendosi aty. Këto fakte dëshmohen nga thirrja telefonike në mes të V.J. dhe Q.R., e regjistruar më 30 qershor 2012 në orën 11:36: Q.R. thërret V.J. dhe ata flasin lidhur me zhdukjen e disa armëve nga vendi i fshehjes afër Pograhës, një fshat përballë kufirit me Dobrosinin. V.J. thotë se "*ata kanë marrë të gjitha që kanë qenë teposhtë, dy 500-she, Barrett-in, fishekët për Barrett, çantat që kanë qenë aty me dy Kallashnikovët.*" Në këtë Q.R. përgjigjet, "*Mutin, i kane marrë të gjitha!*" V.J. po ashtu përmend se janë vjedhur disa uniforma. V.J. i vie keq specifikisht për Kallashnikovin e Q.R. që ky e kishte marrë nga axha/daja i tij. Ata dyshojnë se hajni është bariu që është parë i veshur "me uniformë si të A." dhe plani që të shkohet dhe të shtyhet t'i kthejë armët, ndoshta duke e rrahur. V.J. më tutje shton: "*Kanë mbetur vetëm ato që kemi lënë afër prronit, e di aty ku kemi qenë atë natë. Ata kane marrë të gjitha që kanë qenë përpjetë.*"

Prova të tjera që demonstrojnë përfshirjen e Q.R. në aktivitete terroriste të "LEL" është një lloj liste me fjalë të koduara e gjetur në xhepin e këtij të pandehuri prej të cilave dy fjalë paraqiten shpesh në përgjime, p.sh. "Pulë" dhe "Zogj" që do të thonë respektivisht "Kallashnikov" dhe "Municione".

Provat të cilat i ka marrë parasysh Trupi gjykues kur ka vendosur mbi përgjegjësinë penale të këtij të pandehuri janë një seri dokumentesh të gjetura në kompjuterin e Q.R. të cilat qartësisht tregojnë pikëpamjet e tij politike dhe qartësisht tregojnë se ky i pandehur është aktivist i armatosur kundër autoriteteve serbe. Provat që janë marrë parasysh janë si në vijim

- Seri e fotografive që tregojnë Q.R. duke pozuar me Kallashnikovë, pistoleta dhe mitraloz.
- Një kopje e komunikatës së "LEL" e datës 06/05/2012 dhe 17/05/2012.
- Bisedë në internet në gjuhën Shqipe më 14/12/2011 gjatës së cilës Q.R. shpjegon teorinë e tij se tani është koha për luftë të armatosur dhe se diplomacia nuk do të bëjë asgjë sepse nëse presin, tokat e tjera të populluara me shqiptarë nuk do të çlirohen. Ai thotë, "*Kur të fillojmë çlirimin, ne duhet të zgjerojmë armatën tonë në të gjitha tokat*"

tona.” Ai flet për bashkimin e të gjitha organizatave në një armatë të madhe në mënyrë që të arrihet qëllimi i tyre – çlirimi i të gjitha tokave shqiptare.

- Bisedë në internet në shqip më 25/03/2012 ku Z. Q.R. thotë, *“Zoti më ndihmoftë, jam betuar në armët që mbaj me vete, dhe armën që kam mbushur me barut se nuk do të shkrep pa shkaktuar gjakderdhje, dhe vetëm ju jeni në dijeni për armën, tani kam 19 copë Skorpionë” dhe po ashtu “Nuk mund të vazhdoj më, arma është mbushur, dhe nuk duhet të shkojë kot”*.
- Biseda e datës 19/05/2011 në mes të Q.R. dhe një person tjetër që tregon se Q.R. dëshiron të marrë pjesë në një organizatë në Mitrovicë të udhëhequr nga ky personi tjetër. Është një lloj interviste rekrutimi. Q.R. shpjegon se ndonëse është vetëm 18 vjeç, ai është i gatshëm të marrë pjesë dhe të përmbushë dëshirën e fundit të babait të tij – bashkimin e të gjitha territoreve shqiptare. Personi i shpjegon atij se ky duhet dhënë 300 Euro në fillim. Pas kësaj ai do të marrë të gjitha që i nevojiten – armët, pajisjet etj. Q.R. e informon atë se ky mund të përdor armën e babait të tij. Personi shpjegon se ata marrin armët dhe pajisjet nga Shqipëria dhe të gjithë janë të pajisur njëjtë dhe jo më pak se ushtarët e KFOR-it, vetëm me markë/prodhime të ndryshme.

Të gjitha provat më lart në mënyrë të qartë tregojnë se Z. Q.R. është njëri nga anëtarët më të devotshëm, shumë i politizuar dhe më aktiv të “LEL”.

8. M.A. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Gjatë shqyrtimit kryesor është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se M.A. ka qenë pjesëtar aktiv i grupit terrorist “LEL”. Kjo dëshmohet nga numër enorm i kontakteve telefonike, 232 sosh, në mes të M.A. dhe telefonit të përdorur nga ana e V.J. dhe S.J. në mes të janarit dhe qershorit 2012, dhe specifikisht në periudhën 04 - 26 qershor 2012.

Disa biseda telefonike kanë dëshmuar se M.A. ka qenë i përfshirë në përgatitjen ekspeditës së llojit ushtarak në mes të qershorit 2012. Për shembull, më 14 qershor 2012 në orën 12:27, M.A. thërret V.J. i cili i thotë mos të *“marrë askënd pa vegla, mos eja me duar bosh”*. Pjesëmarrja e M.A. në këtë organizatë terroriste është dëshmuar po ashtu me faktin që vetë ka marrë pjesë në ekspeditën në mes të qershorit 2012 si dhe atë të mesit të majit 2012, gjatë të cilave ai është fotografuar duke vringëlluar armë luftarake.

Kontaktet e ngushta të M.A. me V.J. dëshmohen nga rezultatet e vëzhgimeve të bëra sipas urdëhresës së gjykatës; *shih raportin e parë 15 ditësh mbi vëzhgimin i datës 09 korrik 2012*. Nga raporti mund të shihet se M.A. është takuar me V.J. menjëherë pas kryerjes së sulmit më 28 qershor 2012. Disa ore pas sulmit, V.J. është parë në shoqëri të M.A., V.J. është parë duke imituar aksionin me të shtëna me gjeste. Në raport thuhet se, “duke përdorur dorëne tij të majtë ai vazhdimisht ka reprodukuar një lakore përpara tij dhe lëvizjen përpjetë dhe teposhtë; pak kohë më vonë ai tre herë ka imituar me të dy duart të shtënat me mitraloz”. M.A. po ashtu është parë në shoqëri të V.J. në shumë raste. Më 27 qershor 2012 rreth orës 22.00 janë takuar V.J., G.Xh. dhe M.A. në stacionin e autobusëve ku punon ky i fundit. Më 30 qershor

2012 prapë janë takuar V.J., Q.R. dhe M.A. në stacionin e autobusëve në orët e mbrëmjes. Të nesërmen, më 01 korrik 2012, V.J. është takuar prapë me V.J. dhe ata janë arrestuar së bashku.

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që M.A. dhe V.J. nuk kanë qenë thjesht të njohur por ata kanë punuar së bashku në dobi të grupit. Disa shënime të caktuara të shkruara me dorë janë të rëndësishme specifike:

- Një shënim i datës 31 janar 2007 ora 20:30 thotë si në vijim: *“M.A.[...] ka ardhur te unë [...] për të organizuar më mirë, për të luftuar për Kosovën Lindore [...] prej se e kam thirrur.”*
- Një shënim i datës 08 nëntor 2007 thotë *“[...] Ne po ashtu kemi biseduar për përfshirjen e M.A.- M. – në komandë të grupit tonë apo grupeve të ndara por të koordinojë veprimet”*. (përkthim i lirë-shënim i perkthyesit).

Fakti që M.A. me pseudonimin ‘M.’ ka pasur për qëllim të nxisë një konflikt në rajon në të njëjtën kohë me qëllimet e Lëvizjes dokumentohet në shënimin në ditarin elektronik të gjetur në kompjuterin personal të përdorur nga V.J. dhe S.J. Shënimi i datës 30 shkurt 2012 thotë: *“E hënë, Prishtinë. Kam takuar ‘M.’ dhe S. (shokun e M.-es) ... Kemi biseduar edhe për luftën kundër serbëve ku do të merrnin pjesë M., S. (shoku i M.-es), një shok tjetër i M.-es dhe unë. Por ata thanë që do të sulmonin në mëngjes para agimit”*. Shënimi i njëjtë po ashtu tregon që edhe M.A. ka gjetur anëtarë të rinj, siç është S.S., për grupin.

Ditari elektronik i gjetur në vendbanimin e V.J. dhe S.J. po ashtu tregon që M.A. i njohur si ‘M.’ ka qenë i angazhuar në sigurimin e armëve për grupin dhe ka bashkëpunuar me ta për një kohë të gjatë për të zhvilluar ‘luftë’ kundër ‘serbëve’ dhe kështu të shtyrë përpara qëllimet e përbashkëta terroriste të grupit për të shkaktuar edhe një konflikt në rajon. Një shënim i datës 19 janar 2012 thotë, *“Prishtinë. Kam takuar ‘M.’ dhe kërkova nga ai të gjejë një detonator elektrik”*. Një shënim tjetër i datës 27 janar 2012 thotë: *“Prishtinë. Në stacion të autobusëve me ‘M.’, biseduam lidhur me “detonatorë elektrik dhe predha (tip 500) si dhe zinxhirë për 84”*. Një shënim tjetër i datës 30 prill 2012, e hënë, Prishtinë [...] *takova ‘M.’; ai tha se do të kërkojë të gjejë M84 dhe zinxhirë”*.

Duke marrë parasysh të gjitha provat e mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor ky Trup gjykues nuk ka pasur dyshim që M.A. ka qenë një ndër pjesëtarët e dalluar të organizatës terroriste “LEL”.

9. S.S. akuzat penale të kryerjes së veprave terroriste dhe pjesëmarrja në grup terrorist.

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se S.S. ka qenë pjesëtar aktiv i grupit. Siç është përshkruar më parë, S.S. është bashkuar me pjesëtarët e tjerë të grupit për fotografi duke pozuar dhe duke mbajtur armë të rënda. S.S. nuk ka mohuar se ka qenë i pranishëm dhe se ka pozuar së bashku me personat e tjerë që mund të shihen në foto por deklaroi se prania e tij ka qenë thjesht e rastësishme. Kjo deklaratë është konsideruar nga Trupi gjykues si fare e

besueshme. Grupi ka vepruar me kujdes dhe d.m.th. duke përdorur gjuhë të koduar për të biseduar per armë duke u referuar atyre si “pula” dhe duke përdorur termin “zogj” për municion. Duket plotësisht e pabesueshme që dikujt që nuk i takon grupit t’i jepet qasje në takim dhe armë. Një aspekt tjetër që e bën Q.R. e pabesueshëm është fakti që natyra e një fotografie për të ruajtur një moment të paharrueshëm nuk do të arrihej me dikë në foto që nuk i takon grupit dhe ka qenë aty thjesht rastësisht. S.S. ka qenë në mbledhjen e grupit për të bërë fotografi sepse ai ka qenë pjesëtar aktiv i grupit. Në fund, fakti që S.S. nuk ka qenë vetëm i njohur dhe spektator është dëshmuar nga një shënim në ditarin elektronik të gjetur në kompjuterin e V.J. dhe S.J. Shënimi i datës 20 shkurt 2012 thotë si në vijim: *“Takova ‘M.’ dhe S. (shokun e M.-es). Po ashtu biseduam lidhur me luftën kundër serbëve ku do të merrnin pjesë M., S. (shoku i M.-es), një shok tjetër i M.-es dhe unë. Por ata thanë që do të sulmonin në mëngjes para agimit”*.

Në kontekst të informacioneve të tjera në dispozicion, “S. (shoku i M.-es)” i referohet S.S. “S. (shoku i M.-es)” nuk mund të jetë S.J., meqë S.J. është vetë autori i shënimit. Në fakt, vetë S.S. ka pranuar se është shok i M.A. [“M.”] dhe është njoftuar me pjesëtarët e tjerë të grupit përmes M.-es. Nuk është e arsyeshme të konsiderohet se ka mundur të ketë një S. tjetër shok i M.-es i cili ka biseduar me S.J. lidhur me “luftën kundër serbëve”, sepse ekzistojnë prova gjithëpërfshirëse që tregojnë S.S. dhe M.A. së bashku me pjesëtarët e tjerë të “LEL” në raste të tjera. Prandaj, është vërtetuar se S.S. tashmë e njihnte shumë mirë S.J. së paku që nga shkurti i vitit 2012 – disa muaj para se të bëhen fotografitë e 15 majit 2012. Tema e shënimit dhe konkludimi për interesin e përbashkët në “luftën kundër serbëve” vërtetojnë afërsinë dhe anëtarësimin e S.S. në Lëvizje.

Po ashtu është vërtetuar se S.S. ka marrë pjesë jo vetëm në ekspeditën e majit 2012, por po ashtu edhe në një tjetër në mes të qershorit 2012. Provat sa i përket kësaj janë përgjimi i datës 15 qershor 2012 në orën 02:32 kur S.S. thërret V.J.; ata diskutojnë lidhur me disa rroba që duhet të merren; S.S. deklaron, *“jemi duke u kthyer teposhtë”* dhe pastaj V.J. konfirmon “ok”.

Të gjitha rrethanat dhe provat tregojnë se S.S. nën asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si mysafir i jashtëm që ka marrë pjesë në dy ekspedita por si pjesëtar aktiv i këtij grupi terrorist që vullnetarisht ka marrë pjesë në aksionet e grupit.

[...Kapitulli 10 – duke iu referuar vlerësimit të Gjykatës së J.S. – është e humbur në përkthim shqiptar...]

Mbrojtja ka ngritur shqetësime të përgjithshme kundër datave të fotografive dixhitale. Prokuroria ka vërtetuar datat në fotografitë e gjetura në kompjuterët e V.J. dhe S.J., kjo bazuar në të ashtuquajturën meta-data që përmbajnë fotografitë dixhitale që tregojnë disa informacione të caktuara shtesë siç është apertura, shpejtësia e mbyllësit por po ashtu edhe data dhe koha. Derisa nuk ka dyshim se teorikisht informacione të tilla mund të ndryshohen në një moment të caktuar pasi të bëhen fotografitë, mbrojtja nuk ka paraqitur ndonjë skenar të besueshëm se përse dikush do të ishte futur në hardware-in e kompjuterit të vëllezërve J. për të ndryshuar meta-data të fotografive dixhitale të ruajtura në të. Prandaj, në mungesë të ndonjë

indikatorit që do të dëshmonin të kundërtën, mund të supozohet se datat e fotografive janë te sakta.

Përgjimet e telekomunikimeve.

Trupi gjykues ka konsideruar si prova kryesore një numër të madh të përgjimeve të telekomunikimeve që me besueshmëri dhe plotësisht tregojnë *modus operandi* të pandehurve, rolet e tyre në kryerjen e veprave penale sipas akuzave.

Trupi gjykues përsëri ka shqyrtuar pranueshmërinë e provave të marra me anë të urdhrave të përgjimit të telekomunikimeve sipas nenit 97 të kodit të procedurës penale. Urdhrat e mëposhtme i janë nënshtruar ekzaminimit të mëtejshëm:

Dosja II

- Aktvendimi i datës 14 gusht 2012 që korrigjon urdhrin për përgjim të telekomunikimeve të datës 03 gusht 2012 – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 14 gusht 2012 që pushon përgjimin e telekomunikimeve – Vladimur Mikula
- Urdhri i datës 13 gusht 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Aktvendimi i PSRK i datës 07 gusht 2012 mbi zgjerimin e hetimeve
- Urdhri i datës 03 gusht 2012 mbi pushimin e përgjimit të telekomunikimeve – Mariola Pasnik
- Urdhri i datës 03 gusht 2012 për Masa të Fshehta – Mariola Pasnik

Dosja III

- Urdhri i datës 13 korrik 2012 për përgjim të telekomunikimeve/pushim të përgjimit të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Aktvendimi i PSRK i datës 03 korrik 2012 mbi Zgjerimin dhe ndryshimin e pjesës të Hetimeve
- Aktvendimi i PSRK i datës 01 korrik 2012 mbi Zgjerimin dhe ndryshimin e pjesës të Hetimeve
- Urdhri i datës 01 korrik 2012 mbi konfirmimin e urdhrin urgjent për përgjim të telekomunikimeve/urdhri për përgjim të telekomunikimeve – Ingo Risch
- Urdhri i datës 25 qershor 2012 për gjurmim dhe pozicionim të pajisjeve – Mariola Pasnik
- Aktvendimi i PSRK i datës 20 qershor 2012 mbi zgjerimin e hetimeve
- Urdhri i datës 05 qershor 2012 për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 05 qershor 2012 për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Aktvendimi i PSRK i datës 04 qershor 2012 mbi Fillimin e Hetimeve

Dosja IV

- Aktvendimi i datës 01 tetor 2012 për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula

- Urdhri i datës 26 shtator 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Aktvendimi i PSRK i datës 31 korrik 2012 mbi zgjerimin e hetimeve
- Urdhri i datës 14 shtator 2012 për pushim të përgjimeve të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 12 shtator 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 10 shtator 2012 për Përgjim të Telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 30 gusht 2012 për Shpalesje të të dhënave financiare – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 10 shtator 2012 për zgjerim të përgjimit të telekomunikimeve – Mariola Pasnik
- Urdhri i datës 1 korrik 2012 për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula

Binder V

- Aktvendimi i PSRK i datës 22 tetor 2012 mbi Zgjerimin e hetimeve
- Aktvendimi i PSRK i datës 15 tetor 2012 mbi Zgjerimin e hetimeve
- Aktvendimi i PSRK i datës 11 tetor 2012 mbi Zgjerimin e hetimeve
- Urdhri i datës 10 tetor 2012 për Masa të Fshehta (për përgjim të telekomunikimeve) – Mariola Pasnik

Dosja VI

- Ndarësi 1 - Aktvendimi i datës 28 dhjetor 2012: Zgjatja e hetimeve për gjashtë muaj deri më 04 qershor 2013 – Vladimir Mikula
- Ndarësi 5 – Aktvendimi i datës 24 gusht 2012 mbi pushimin e përgjimit të telekomunikimeve (vetëm përkthimi shqip dhe Aneksi) – Vladimir Mikula
- Ndarësi 8 – Urdhri i datës 10 dhjetor 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Ndarësi 11 – Aktvendimi i PSRK i datës 22 nëntor 2012 mbi zgjerimin e hetimeve
- Ndarësi 11 – Aktvendimi i datës 27 nëntor 2012 mbi zgjatjen e hetimeve për gjashtë muaj deri më 04 qershor 2013 (J.S.) – Vladimir Mikula
- Ndarësi 11 – Aktvendimi i datës 26 nëntor 2012 për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula

Dosja VII

- Urdhri i datës 12 nëntor 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula (Ndarësi 3)
- Urdhri i datës 07 nëntor 2012 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula (Ndarësi 3 and 4)
- Urdhri i datës 24 tetor 2012 për pushim të përgjimit të telekomunikimeve – Vladimir Mikula (Ndarësi 5)
- Urdhri i datës 24 tetor 2012 për pushim të përgjimit të telekomunikimeve – Vladimir Mikula (Ndarësi 5)

- Urdhri i datës 24 tetor 2012 për pushim të përgjimit të telekomunikimeve – Vladimir Mikula (Ndarësi 11)

Dosja 8 e procedurës paraprake

- Urdhri i datës 07 shkurt 2013 për Masa të Fshehta për përgjim të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 05 shkurt 2013 për Masa të Fshehta të Regjistrimit të telefonatave dhe SMS – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 24 janar 2013 për Zgjatje të përgjimit të telekomunikimeve – Vladimir Mikula
- Urdhri i datës 04 janar 2013 për Masa të Fshehta të përgjimit të telekomunikimeve – Dariusz Sielicki (Ndarësi 30).

Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se të gjithë urdhrat e gjykatësve të procedurës paraprake janë lëshuar në përputhje me procedurat përkatëse ligjore bazuar në aplikimet e PSRK se si duhet dhe siç kërkohet nga dispozitat ligjore arsyetuan domosdoshmërinë e masave të tilla. Urdhrat janë të justifikuara siç duhet dhe të lëshuar ndaj të pandehurve që ishin objekt i procedurës penale. Trupi gjykues ishte i mendimit se të drejtat kushtetuese e të pandehurve nuk ishin shkelur si veprat penale u vu nën fushëveprimin e nenit 90 të KPP; parakushtet të Nenit 88, par. 3 ishin plotësuar. Rezultati i mëtejshëm i hetimeve vërtetohet se përgjimet e telekomunikimeve kanë ndihmuar në hetimin e veprave penale dhe kanë lehtësuar për të mbledhur prova vendimtare. Trupi gjykues arriti në përfundimin se PSRK-ja kishte të drejtën për të vazhduar hetimin, edhe pse aktivitetet kriminale ishin të njohur për këtë agjenci të zbatimit të lighit pasi objektivi kryesor ishte si për të ndaluar aktivitetet kriminale të të pandehurve të përfshirë tashmë në organizatë terroriste dhe në të njëjtën kohë për të gjithë individëve të përfshirë në kjo organizatë terroriste dhe plane e objektet që janë vënë në listën e sulmeve të mundshme terroriste në të ardhmen.

Pranueshmëria e provave të mbledhura nga bastisja.

Përveç kësaj, ky Trup gjykues konsideroi pranueshmërinë e provave të mbledhura nga bastisja pasi këto prova janë konsideruar si vendimtare dhe kanë ndihmuar në ngritjen e fakteve dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve.

Provat që janë konsideruar me rëndësi thelbësore janë konfiskuar në rezidencën e V.J. dhe S.J. Vëmendje e veçantë i është kushtuar provave të mëposhtme:

- Origjinalja e komunikatës e vulosur dhe nënshkruar lidhur me sulmin e 28 qershor 2012;
 - Vula zyrtare e Lëvizjes korresponduese me vulën e gjetur mbi kërkesën;
 - Materiale të ndryshme në lidhje me aktivitetet e "“LEL”", duke përfshirë edhe statutin e saj, rregulloret, dhe formularët e aplikimit konkretisht:
- a) Përmbledhje nga faqe të ndryshme të internetit në lidhje me sulmin e 17 majit 2012 (bashkngj. 3);

- b) Disa përmbledhje të ngjashme për sulmin e 28 qershorit 2012 (bashkngj. 4);
- c) 18 formularë të certifikatave të anëtarësimit të “LEL” (bashkngj. 5);
- d) 48 formularë të pajisjeve ushtarake të Ushtrisë Shqiptare (bashkngj. 6);
- e) Një deklaratë politike nga “LEL” lidhur me situatën në rajonin e Preshevës e datës maj 2012 (bashkngj. 7);
- f) Statuti i “LEL” (bashkngj. 8).
- g) Dokumenti “Organizata sekrete...” e nënshkruar nga “G.S.”, “S.J.” (bashkngj. 2).
- h) Dokumenti “Shpallje mbi situatën në rajon”, e nënshkruar nga “S.J., Drejtorati Rajonal i Policisë së “LEL”” (bashkngj. 3).

- Manuale ushtarake, fotografi dhe skica lidhur me aktivitete dhe armë ushtarake
 - a) 1-Fletore me shënime me dorë. (Lidhur me armë)
 - b) 3-Dokument me titull “Organizata sekrete ...” (I përkthyer: është një dokument origjinal i vjetër i datës 18/09/2000 i nënshkruar nga “G.S.Z.”, që është një nga pseudonimet e Skenderbeut)
 - c) 4-Vizatime të granatave dhe granatë-hedhësve.
 - d) 6-Libër mbi mina.
 - e) 7-Fletore me shënime me dorë dhe vizatime të armëve të ndryshme. (Lidhur me armë)
 - f) 10-Manual “Si të luftohet për të mbijetuar”.
 - g) 11-Letërnjoftim i dyshimtë i A.S.
 - h) 14-Letër me logo të “LEL”.
 - i) 15-idem. I përkthyer
 - j) 16-idem. I përkthyer
 - k) 17-Dokumente të ndryshme (lidhur me armë)
 - l) 18-idem. (lidhur me armë)
 - Kompjuter personal që përmban dokumente elektronike lidhur me terrorizëm, balistikë, argumente paramilitare, marrje të pengjeve (Beslan, Kepi i Afrikës...), eksplozivë, kryengritje dhe të ngjashme;
 - Harta nga Google të zonës së Dobrosinit, të gjetura në PC-në e njëjtë;
 - Një revole

Të gjitha këto prova janë gjetur bazuar në urdhrin e gjykatësit të procedurës paraprake siç kërkohet me nenin 111 të KPP dhe nuk është vërejtur asnjë parregullsi që përmendet në këtë nen.

[...Kapitulli “Analiza ligjore” është e humbur në përkthim shqiptar...]

Trupi gjykues ka ekzaminuar thellësisht të gjitha provat e mbledhura në këtë çështje dhe ka ardhur në përfundim se të pandehurit kanë kryer veprat penale si në vijim:

I pandehuri V.J.

SHPALLET FAJTOR

për pikën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht i sanksionuar sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

sepse është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkë-kryerje me pjesëmarrës të tjerë në grup terrorist të njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërprejnë aktivitetet policore në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e nacionalitetit shqiptar të Policisë së Serbisë të lëshojnë vendet e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojnë “komunitetin ndërkombëtar” të dërgojnë forcat paqeruajtëse në rajon,

1. ka marrë pjesë në sulmin i cili ka dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare Serbe që ndodhej në Bujanovc dhe i ka shkakuar lëndime të lehta trupore policit serb B.M., duke shtënë me armë të ndryshme, të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve të kalibrit të ndryshëm (në çdo rast më shumë se 100), në bashkë-kryerje me G.Xh. dhe E.M.; sulmi ka ndodhur në Dobrosin, më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00,
2. ka poseduar dhe kontrolluar në mënyrë të kundërligjshme një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë pushkë sulmi, mitraloza dhe granatë-hedhës) të cilat kanë qenë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkë-kryerje me G.Xh., G.L., S.J., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar më së voni në prill 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri V.J. po ashtu shpallet fajtor për pikën 2, ORGANIZIM TË GRUPIT TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 1 i KPK, aktualisht i sanksionuar sipas nenit 143 paragrafi 1 i KPRK, sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka organizuar dhe udhëhequr grupin terrorist të njohur si “LEL”, duke siguruar armatim, uniforma dhe mjete të tjera që nevojiten për aktivitetet e grupit, duke vendosur cilat aktivitete do të ndërmerren nga grupi, kur, ku dhe nga kush do të ndërmerren këto aktivitete, duke marrë pjesë personalisht në së paku një nga sulmet e kryera nga grupi, të përshkruar më lart, duke paraqitur qëllimet politike të grupit, duke përfshirë edhe diktimin e pranimin të përgjegjësisë për sulmet e kryera nga grupi. Aktivitetet kanë ndodhur në një vend të paspecifikuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri S.J.

SHPALLET FAJTOR

për pikën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht i sanksionuar sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sepse është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkë-kryerje me pjesëmarrës të tjerë në grupin terrorist të njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërprejnë aktivitetet policore në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e nacionalitetit shqiptarë të Policisë së Serbisë të lëshojnë vendet e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojnë “komunitetin ndërkombëtar” të dërgojnë forcat paqeruajtëse në rajon, ka marrë pjesë në sulmin i cili ka dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare Serbe që ndodhej në Bujanovc, duke shtënë me armë të ndryshme, të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve të kalibrit të ndryshëm, në bashkë-kryerje me E.M. dhe numër të pacaktuar të kryerësve të tjerë. Sulmi ka ndodhur në Dobrosin (Komuna e Gjilanit), më 7 tetor 2012 rreth orës 21.35 dhe sepse ka poseduar dhe kontrolluar në mënyrë të kundërligjshme një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë pushkë sulmi, mitraloza dhe granatë-hedhës) të cilat kanë qenë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkë-kryerje me V.J., E.M., G.L., A.Z., G.Xh.,

S.S., M.A., Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar më së voni në prill 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri S.J. po ashtu shpallet fajtor për pikën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht i sanksionuar sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkë-kryerje me V.J., E.M., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R., aktivisht kane marrë pjesë në grupin terrorist të njohur si “LEL”, duke përpiluar pranimet e përgjegjësisë, duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkuara më lart, dhe duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij. Aktivitetet kanë ndodhur në një vend të paspecifikuar në Kosovë, duke filluar më së voni në prill 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri G.L.

SHPALLET FAJTOR

për pikën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht i sanksionuar sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sepse është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkë-kryerje me pjesëmarrës të tjerë në grup terrorist të njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërprejnë aktivitetet policore në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e nacionalitetit shqiptar të Policisë së Serbisë të lëshojnë vendet e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojnë “komunitetin ndërkombëtar” të dërgojnë forcat paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe kontrolluar në mënyrë të kundërligjshme një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë pushkë sulmi, mitraloza dhe granatë-hedhës) të cilat kanë qenë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkë-kryerje me V.J., S.J., A.Z., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S. në një vend të paspecifikuar, duke filluar më së voni në prill 2012 dhe deri më 13 shkurt 2012.

I pandehuri G.L. po ashtu shpallet fajtor për pikën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht i sanksionuar sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkë-kryerje me V.J., S.J., A.Z., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S., aktivisht kane marrë pjesë në grupin terrorist të njohur si “LEL”, që ka kryer sulmet në instalimet e Policisë Serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke kryer veprat penale më lart në një vend të paspecifikuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 dhe deri më 13 shkurt 2013.

I pandehuri **G.Xh.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1, n.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas neneve 135(1.10) dhe 136(1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

(KPRK) sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpres aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojnë forcat paqeruajtëse në rajon, ka marrë pjesë në një sulm ku është dëmtuar kontejneri i Policisë Kufitare të Serbisë i vendosur në Bujanovc dhe i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore oficerit të policisë së Serbisë B.M., duke shtënë me armë të ndryshme, të gjitha në posedim dhe përdorim të paligjshëm, një numër të papërcaktuar të shtënash të kalibrave të ndryshëm (sidoqoftë më shumë se 100), në bashkëkryerje me V.J. dhe E.M. në Dobrosin (komuna e Gjilanit), më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00 dhe për shkak se ai ka pasur në posedim dhe ka kontrolluar në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) që ishin në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri G.Xh. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R., ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist i cili e quan veten “LEL”, duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkuara më lartë, dhe me fjalë tjera duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit në një vend të paspecifikuar të Kosovës, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 12 korrik 2012.

I pandehuri **Q.R.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpres aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojnë forcat paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe ka kontrolluar një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) që ishin në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., S.S. në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri Q.R. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 (3) i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 (2) i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., S.S., ka marrë pjesë aktivisht në një të ashtuquajtur grup terrorist i cili e quan veten “LEL” i cili ka kryer sulme në pika të

policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lartë në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri **M.A.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE**, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojë forcat paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe ka kontrolluar një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) që ishin në dispozicion të grupit terrorist “LEL” në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., E.M., Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri M.A. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST**, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga provat se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., E.M., dhe Q.R., ka marrë pjesë aktivisht në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL” i cili ka kryer në mes tjerash sulme në pika të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lartë në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 1 korrik 2012.

I pandehuri **S.S.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE**, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojë forcat paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe ka kontrolluar në mënyrë një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) që janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL” në

bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M. dhe Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri S.S. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga provat se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., M.A., E.M., dhe Q.R., ka marrë pjesë aktivisht në një të vetëquajtur grup terrorist i njohur si “LEL” i cili ka kryer sulme në pika të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lartë në një vend të paspecifikuar të Kosovës, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri **E.M.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1, n.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas neneve 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpres aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojë forcat paqeruajtëse në rajon, ka marrë pjesë në një sulm ku është dëmtuar kontejneri i Policisë Kufitare të Serbisë i vendosur në Bujanovc dhe i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore oficerit të policisë së Serbisë B.M., duke shtënë me armë të ndryshme, të gjitha në posedim dhe përdorim të paligjshëm, një numër të papërcaktuar të shtënash të kalibrave të ndryshëm (siduoftë më shumë se 100), në bashkëkryerje me V.J. dhe G.Xh. në Dobrosin (komuna e Gjilanit), më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00; për shkak se ka marrë pjesë në një sulm në kontejnerin e policisë kufitare të Serbisë të vendosur në Bujanovc, duke shtënë me armë të ndryshme, të gjitha në posedim dhe në kontroll në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar të shtënave të kalibrave të ndryshëm; në bashkëkryerje me S.J. dhe me një numër të papërcaktuar të kryerësve tjerë në Dobrosin (komuna e Gjilanit), më 7 tetor 2012 rreth orës 21.35 dhe për shkak se ka poseduar dhe ka kontrolluar në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) që janë në dispozicion të grupit terrorist “LEL”, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A. dhe Q.R. në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri E.M. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga provat se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R., ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist që e quan veten “LEL”, në mes tjerash duke kërkuar armatim, duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit

dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lartë në një vend të paspecifikuar të Kosovës, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 16 tetor 2012.

I pandehuri **A.Z.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 1, **KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE**, në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 1.10, nenin 110 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e dënueshme sipas nenit 135 paragrafi 1.10 dhe 136 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një të ashtuquajtur grup terrorist i njohur si “LEL”, me qëllim që të detyrojnë padrejtësisht Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpres aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit, të detyrojnë padrejtësisht pjesëtarët e forcave policore të Serbisë të kombësisë Shqiptare të largohen nga vendet e tyre të punës dhe të detyrojnë padrejtësisht “komunitetin ndërkombëtar” të pozicionojë forcat paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe ka kontrolluar në mënyrë të paligjshme një numër të papërcaktuar të armëve (përfshirë pushka sulmi, mitraloza dhe granata-hedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “LEL” në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., Q.R., G.Xh., M.A., E.M. dhe S.S.N në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 17 tetor 2012.

I pandehuri A.Z. është gjetur po ashtu fajtor për akuzën 2, **PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST**, në kundërshtim me nenin 113 paragrafi 3 i KPK, aktualisht e dënueshme sipas nenit 143 paragrafi 2 i KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga provat se i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J., S.J., G.L., Q.R., G.Xh., M.A., E.M., S.S., ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist i njohur si “LEL”, (i cili në mes tjerash ka kryer sulmet në pikat e policisë së Serbisë më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012) duke vënë veten e tij në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e grupit dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lartë në një vend të paspecifikuar, duke filluar jo më vonë se prilli i vitit 2012 dhe deri më 17 tetor 2012.

I pandehuri **J.S.**

SHPALLET FAJTOR

për akuzën 4, **FURNIZIMI DHE SHITJA E PAAUTORIZUAR E ARMËVE**, e paraparë dhe e ndëshkueshme sipas nenit 327 të Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme sipas nenit 372 të KPRK për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm përmes provave se i pandehuri pa autorizim ka ndërmjetësuar dhe ka përfunduar një numër të transaksioneve për shitjen e armëve të zjarrit të kalibrave të ndryshëm, përfshirë shitjen e armës së zjarrit të paspecifikuar të përmendur nën akuzën 3 më lartë në një vend të papërcaktuar, më 7 nëntor 2012.

për akuzën 6, **PËRDORIMI I ARMËS**, e paraparë dhe e ndëshkueshme sipas nenit 375 të KPRK, për shkak se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm përmes provave se i pandehuri ka përdorur dhe ka shtënë me armë të cilën e ka poseduar në mënyrë të paligjshme. Në një vend të papërcaktuar, më një datë të papërcaktuar para apo më datë 3 janar 2013.

Ekzistimi i grupit terrorist “LEL”.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave në këtë lëndë, trupi gjykues arriti në përfundim se grupi terrorist i njohur si “LEL” ka ekzistuar në Kosovë të paktën që nga maji i vitit 2012. Kjo organizatë terroriste “LEL” ka pasur synime politike që lidhen me situatën e Shqiptarëve etnik që jetojnë në Serbinë Jugore. Ky grup përbëhej së paku nga nëntë anëtarë si në vijim, të gjithë Shqiptarë etnik, nga Serbia dhe Kosova: V.J. dhe S.J., G.L., G.Xh., Q.R., M.A., E.M., S.S. dhe A.Z. Trupi gjykues arriti në përfundim se kjo organizatë terroriste ka pasur një strukturë dhe anëtarëve të saj u ishin caktuar role të ndryshme. Ky grup ka zotëruar dhe ka pasur në kontroll armë të rënda, të ruajtura që nga maji/qershori i vitit 2012 në së paku dy vende në Kosovën Lindore. Kjo organizatë terroriste ka zotëruar uniforma ushtarake. Për më tepër “LEL” ka filluar tri sulme të armatosura ndaj pikave të policisë së Serbisë afër fshatit Dobrosin, më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012. Kjo organizatë terroriste kishte planifikuar të ekzekutonte sulme tjera në Republikën e Serbisë. Në përgatitjen dhe implementimin e strategjisë dhe kapaciteteve ushtarake kundër Republikës së Serbisë, kjo organizatë terroriste, ka kryer së paku dy ekspedita të tipit ushtarak në Kosovën Lindore, më 15 maj 2012 dhe më 14-16 qershor 2012. Qëllimi politik i kësaj organizate terroriste ishte

- Të detyrojnë Qeverinë e Republikës së Serbisë të ndërpres aktivitetin e vet policor në rajonin e Bujanovcit;
- Të detyrojnë anëtarët e forcave të policisë së Serbisë të kombësisë Shqiptare të larohej nga vendet e tyre të punës; dhe
- Të detyrojnë “komunitetin ndërkombëtar” të vendosë forcat paqeruajtëse në rajon.

Pjesëmarrja në grupin terrorist “LEL”.

Provat e mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor qartë tregojnë se të gjithë të pandehurit të ngarkuar në aktakuzë me përjashtim të J.S., kanë qenë anëtarë aktiv të “LEL”. Provat lidhur me këtë janë paraqitur dhe janë vlerësuar në detaje si më lartë.

Kryerja e sulmeve terroriste përmes

- **Sulmit të 28 qershorit 2012**

Raporti i policisë mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes datë 28/06/2012, më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00 në mëngjes pika e kontrollit e policisë së Serbisë që gjendet në Dobrosin ishte sulmuar me armë zjarri. Gjatë këtij sulmi, oficeri i policisë së Serbisë (B.M.) ishte plagosur lehtë. Raporti i njësisë së forenzikës i policisë së Kosovës lidhur me provat e mbledhura më 28/06/2012 pas sulmit tregon se në vendin e ngjarjes janë gjetur 157 gëzhoja të 2 kalibrave të ndryshëm, 7,62x39mm dhe 7,9x57mm. Një raport i mëtejshëm qartëson se për këtë sulm janë përdorur tri armë:

1. Armë e kalibrit 7.62x39mm, e cila ka shtënë 44 predhat e gjetura të kalibrit të njëjtë;
2. Armë e kalibrit të njëjtë, e cila ka shtënë 24 predhat tjera të kalibrit të njëjtë;
3. Armë e kalibrit 7.62x54mm, e cila ka shtënë 93 predhat e gjetura të kalibrit të njëjtë.

Ditën e nesërme, "LEL" publikoi një komunikatë në internet, ku merrte përgjegjësinë për këtë sulm.

Ekzistojnë prova dërmuese (të mbledhura përmes përgjimeve të telefonave, pozitive të celularëve, regjistrimit të thirrjeve telefonike, vëzhgimit fotografik) se anëtarët si në vijim të "LEL" e kanë kryer këtë sulm: V.J., G.Xh. dhe E.M.

- **Sulmi i 7 tetorit 2012**

Raporti i policisë mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes datë 8 tetor 2012, më 7 tetor 2012 rreth orës 21.40 pika e kontrollit e policisë së Serbisë e vendosur në Dobrosin ishte sulmuar përsëri me armë zjarri. Nuk është raportuar për viktima. Raporti tregon se janë gjetur 15 predha të kalibrit 7.62mm dhe 48 predha tjera të kalibrit të panjohur në vendin e ngjarjes që gjendet afër Stubline (në kufirin në mes Kosovës dhe Serbisë). Sulmi është kryer nga S.J. dhe E.M.

Zbatimi i të drejtës materiale.

Trupi gjykues vendosi, bazuar në nenin 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës që lidhur me të gjithë të pandehurit do të zbatohet Kodi Penal i Kosovës (UNMIK/Rreg/2003/25) si rregull i përgjithshëm. Në rastet kur Kodi i ri Penal është më i favorshëm për të pandehurit atëherë këto dispozita do të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Dispozita e përmendur më lartë lexon si në vijim:

"1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm."

Trupi gjykues konstaton se Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi që nga 1 janari i vitit 2013 dhe rregullon veprat penale të terrorizimit në

Neni 135

Përkufizimet për dispozitat e terrorizimit në nenet 121-145

Për qëllime të neneve 121-145 të këtij Kodi:

1. Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit - kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare:

1.1. vrasja apo vrasja e rëndë në shkelje të nenit 178 dhe 179 të këtij Kodi;

1.2. shtytja apo ndihma në vetëvrasje në shkelje të nenit 183 të këtij Kodi;

1.3. sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor në shkelje të neneve 187-189 të këtij Kodi;

1.4. veprat penale kundër integritetit seksual në shkelje të neneve 230-232, 235-239 ose 241 të këtij Kodi;

- 1.5. marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria në shkelje të neneve 175, 194 ose 196 të këtij Kodi;
- 1.6. ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore; ndotja ose shkatërrimi i mjedisit në shkelje të neneve 270 dhe Kapitullit XXVII të këtij Kodi;
- 1.7. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm; zjarrvënia apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia në shkelje të neneve 334 ose 365 të këtij Kodi;
- 1.8. shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik në shkelje të neneve 129, 366, 378 ose 380 të këtij Kodi;
- 1.9. furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;
- 1.10. përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumtimet për ose ndërtimi i armëve biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;
- 1.11. rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht në shkelje të nenit 173 të këtij Kodi;
- 1.12. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 174 të këtij Kodi;
- 1.13. rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes në shkelje të nenit 164 të këtij Kodi, ose rrëmbimi i mjeteve tjera të transportit publik apo të transportit të mallrave;
- 1.14. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil në shkelje të nenit 165 të këtij Kodi;
- 1.15. rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar në shkelje të nenit 166 të këtij Kodi;
- 1.16. rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në prapun kontinental në shkelje të nenit 167 të këtij Kodi;
- 1.17. përvetësimi, përdorimi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare në shkelje të nenit 176 të këtij Kodi;
- 1.18. kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare në shkelje të nenit 177 të këtij Kodi; ose
- 1.19. kanosja për kryerjen e ndonjëres prej veprave të saktësuara në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.18 të këtij paragrafi.
2. Shprehja **“fonde”** përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë por pa u kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letërkreditë.
3. Shprehja **“burime financiare”** përfshin, por nuk kufizohet në, dhënien me qira, objektet e thezoreve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, armët, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme.
4. Shprehja **“grup terrorist”** nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit. Grup i strukturuar nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.

Neni 136

Kryerja e veprës terroriste

1. Kushdo që kryen një veprë terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 143

Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist

1. Kushdo që organizon ose drejton një grup terrorist dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.
2. Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.

Kodi Penal i Kosovës ka sistemuar veprën penale në nenet si në vijim:

PËRKUFIZIMI I TERRORIZMIT

Neni 109

Sipas neneve 110 – 113 të këtij Kodi:

(1) Shprehja “terrorizëm” do të thotë kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullatës, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike o sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare, siç janë:

- 1) Vrasja;
- 2) Lëndim i rëndë trupor;
- 3) Marrja peng;
- 4) Rrëmbimi;
- 5) Heqja e paligjshme e lirisë;
- 6) Ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore;
- 7) Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm;
- 8) Shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike;
- 9) Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve;
- 10) Mbajtja e paautorizuar e armëve në pronësi, në kontroll, në posedim ose në përdorim;
- 11) Rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht;
- 12) Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to;

44

- 13) Rrëmbimi i fluturakes;
- 14) Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil;
- 15) Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar;
- 16) Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental;
- 17) Përvetësimi, përdormi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare ose
- 18) Kërcënimet për përdorimin, për kryerjen e vjedhjes ose të grabitjes së materialeve nukleare.

(2) Shprehja “fonde” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar dhe dokumentet apo instrumentet ligjore të çfarëdo forme, siç janë mjetet elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e

pronësisë ose të interesit për ato mjete, duke përfshirë në mes të tjerash kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letërkreditë.

(3) Shprehja “burime finaciare” përfshin dhënien me qira, objektet e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike përveç medikamenteve të domosdoshme.

(4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role zyrtarisht të përcaktuara për anëtarët e tij, kohëzgjatjen e anëtarësisë ose të organizimit të zhvilluar.

(5) Shprehja “grup terrorist” do të thotë grup i strukturuar prej më shumë se dy personave i themeluar gjatë një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit.

(6) Shprehja “përkrahje grupit terrorist” do të thotë rekrutimi i anëtarëve për një grup terrorist, fshehja e grupit terrorist ose e anëtarëve të tij, pengimi i zbulimit dhe i kapjes së grupit terrorist ose e anëtarëve të tij, sigurimi a mbledhja e fondeve ose e mjeteve të tjera financiare me qëllim, dijëni ose arsye të bazuar për të besuar se ato do të përdoren tërësisht ose pjesërisht nga një grup terrorist.

KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE

Neni 110

(1) Kushdo që kryen një vepër terroriste dënohet me burgim prej dhjetë deri në njëzet vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore, kryerësi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet.

(3) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekje, kryerësi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste

Neni 113

(1) Kushdo që organizon ose udhëheq një grup terrorist dënohet me gjobë deri në 500,000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(2) Kushdo që i siguron përkrahje një grupi terrorist dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(3) Kushdo që merr pjesë aktivisht në një grup terrorist dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Veprat penale ndaj J.S.

Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve

Neni 327

(1) Kushdo që furnizon, transporton, prodhon, këmben ose shet armë pa autorizim dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni përfshin sasi të madhe armësh, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(3) Armët konfiskohen.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve

Neni 328

(1) Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10,000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni përfshin një sasi të madhe armësh, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 372

Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse

1. Kushdo që në shkelje të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatë mijëpesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Për qëllime të këtij neni, shprehja “prodhim” i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin

e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.

4. Armët, mjetet për transportimin e armëve dhe mjetet për prodhimin e armëve konfiskohen.

Neni 375

Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm

1. Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

185

3. Arma apo mjeti i rrezikshëm i përdorur në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Kryerja e veprave terroriste

Krahasimi i dy kodeve penale lidhur me veprat penale të kryerjes së veprave penale të terrorizmit na çon në përfundim se kodi i ri penal është më i favorshëm për të pandehurit meqë dënimet ndryshojnë nga jo më pak se 5 vjet deri jo më shumë se 25 vjet (neni 45) ndërsa kodi i mëparshëm penal parasheh dënime prej 10 vjet deri në 20 vjet. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit në veçanti përfshirjen e të pandehurve në organizatë terroriste, numrin e sulmeve kriminale dhe veprime tjera të mundshme, ky trup gjykues arriti

në përfundim se përsa i përket të gjithë të pandehurve, dënimi duhet caktuar duke filluar nga cilësimi ligjor më i butë domethënë nga 5 vjet në vend të 10 vjet.

Organizmi i grupit terrorist

Në rastin e veprës penale të organizimit të grupit terrorist e që zbatohet ekskluzivisht ndaj V.J. krahasimi i të dy legjislacioneve penale na çon tek ajo se kodi i mëparshëm penal është më i favorshëm për këtë të pandehur. Duke lënë anash gjobën që në të dy rastet është e njëjtë – deri në 500.000 Euro, burgimi është i ndryshëm dhe në rastin e kodit të vjetër fillon nga 7 deri në 20 vjet ndërsa kodi i ri përcakton dënimin prej 10 deri në 20 vjet. Trupi gjykues përsëri ka qenë i mendimit se përfshirja e V.J. në organizimin e grupit terrorist, rrethanat e tij personale, të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese do të rezultojnë në një dënim prej 9 vjetësh.

Pjesëmarrja në grup terrorist

Duke marrë parasysh veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist në krahasim me kodin e ri penal i cili parasheh burgim prej 5 deri në 10 vjet, kodi i vjetër penal është më favorshëm meqë dënimi fillon nga 1 vjet dhe përfundon me dënimin maksimal prej 10 vjetëve. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit në veçanti përfshirjen e të pandehurve në organizatë terroriste, numrin e sulmeve kriminale dhe veprimet tjera të mundshme, ky trup gjykues arriti në përfundim se përsa i përket të gjithë të pandehurve, dënimi duhet të caktohet duke filluar nga cilësimi ligjor më i butë domethënë 1 vjet në vend të 5 vjetëve, prandaj kodi i vjetër penal do të mbizotërojë.

Furnizimi dhe shitja e paautorizuar i armëve

Duke konsideruar këtë veprë penale, trupi gjykues arriti në përfundim se dispozitat ligjore të kodit të vjetër penal janë më të favorshme për të pandehurin J.S. Neni 327 i kodit të vjetër penal parasheh se për këtë veprë penale, kryesi do të dënohet me gjobë deri në 7.500 Euro ose me dënim prej 1 deri në 8 vjet, ndërsa kodi i ri penal për të njëjtën veprë penale parasheh në nenin 372 dënimin me gjobë deri në 7.500 Euro dhe burgim prej 1 deri në 8 vjet. Krahasimi i këtyre dy dispozitave çon deri te përfundimi se kodi i mëparshëm penal është më i favorshëm për të pandehurin meqë gjykatës i jepet alternativa e gjobës ose e burgimit, derisa kodi i ri penal parasheh vetëm një opsion; gjobë dhe burgim. Në atë rast, trupi gjykues konsideroi kodin e vjetër penal si bazë ligjore për dënimin e këtij të pandehuri.

Përdorimi i armëve

Nga provat del se J.S. ka kryer veprën penale të përdorimit të armëve në një datë të papërcaktuar përpara apo më datë 3 janar 2013. Duke marrë parasysh dyshimet lidhur me kur saktësisht kanë ndodhur vepra penale, trupi gjykues vendosi të zgjidhë dyshimet në dobi të pandehurit J.S. dhe kështu zbatoi dispozitën e nenit 375 të kodit të ri.

Ligji mbi amnistinë

Duhet të konstatohet se prokurori duke zbatuar ligjin mbi amnistinë (Ligji NR.04/L-209) hodhi poshtë akuzat si në vijim ndaj

- V.J., akuzën për kontroll dhe posedim të paautorizuar i armëve
- S.J., akuzën për kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve
- Q.R., akuzën për kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve
- J.S., akuzat 1, 2 dhe 5 për kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve

Si rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të refuzojë akuzat në pajtim me nenin 363 1.1 të KPP. Në kundërshtim me parashtrimet e paraqitura nga mbrojtja, ky trup gjykues arriti të mendimi se ligji mbi amnistinë në asnjë rrethanë nuk ka ndikim mbi përgjegjësinë penale përse i përket veprës penale të kryerjes së veprave terroriste. Duhet të nënvizohet fuqimisht se Ligji mbi Amnistinë liston saktësisht veprat penale të cilat i nënshtrohen amnistisë dhe në asnjë paragraf nuk përmendet se kryerja e veprave terroriste amnistohet. Për më tepër, fakti se vepra e caktuar penale amnistohet nuk do të thotë se nuk është kryer fare apo është dekriminalizuar në kuptim të asaj që nuk është më vepër penale dhe më nuk ndiqet penalisht. Pra veprat e amnistuara penale mbeten në legjislaturën penale, por për arsye të ndryshme ato nuk ndiqen penalisht. Përveç kësaj, trupi gjykues konstaton se i ka shpëtuar vëmendjes së mbrojtjes plotësisht se sipas saktësisht ligjor të terrorizimit, kjo vepër penale kryhet me qëllim special domethënë që të frikësojë seriozisht popullatën, të detyrojë padrejtësisht një entitet publik apo organizatë ndërkombëtare të bëjë apo të abstenojë nga bërja e ndonjë veprimi ose të destabilizojë seriozisht apo të shkatërrojë strukturën fundamentale, politike apo sociale të Kosovës, të një shteti (tjetër nga Kosova – theksim i shtuar) apo një organizatë ndërkombëtare. Kryerja e veprave penale të renditura në nenin 109 është vetëm një mënyrë, një mjet për të arritur qëllimet. Gjatë gjykimit është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të gjithë të pandehurit kanë vërtetuar qëllimet e qarta dhe kanë ushtruar forma të terrorit për t'i vënë në veprim.

Dënimi

Trupi gjykues është udhëhequr nga dispozita e nenit 64 kur vendosi lidhur me dënimet për secilin të pandehur.

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR MATJEN E DËNIMIT

Neni 64

(1) Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së

veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

(2) Nëse gjykata cakton dënimin për veprën penale të kryer nga recidivisti posaçërisht merr parasysh nëse personi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe sa kohë ka kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm ose nga dënimi i mbajtur ose i falur.

(3) Me rastin e matjes së dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale dhe të ardhurat e tjera të tij, pasurinë dhe detyrimet e tij.

V.J.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re,
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.
- Rol të jashtëzakonshëm dhe drejtues që ai kishte në grup
- Marrja pjesë në sulmin terrorist ndaj policisë kufitare të Serbisë më 28 qershor 2012

Pas marrjes parasysh në mënyrë të kujdesshme dhe pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi i cili është proporcional me seriozitetin e veprave penale është 6 vjet burgim për kryerjen e veprave terroriste dhe 7 vjet burgim dhe gjobë 1000 Euro për organizimin e grupit terrorist. Dënimi unik prej 9 vjet burgim do të rezultojë që në të ardhmen ai të respektojë rendin juridik.

S.J.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re,
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt

ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile. Marrja pjesë në sulmin terrorist ndaj policisë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 7 tetor 2012 Rol të jashtëzakonshëm dhe drejtues që ai kishte në grup.

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 6 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 4 vjet dhe dënimi unik 8 vjet.

G.L.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re,
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 5 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 5 vjet e 6 muaj.

G.Xh.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re,
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.
- Marrja pjesë në sulmin terrorist ndaj policisë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 28 qershor 2012

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 6 vjet, për akuzën kriminale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 6 vjet dhe 6 muaj.

Q.R.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re,
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.
- Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 5 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 5 vjet e 6 muaj.

M.A.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Ky i pandehur ka familje
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 5 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 5 vjet e 6 muaj.

S.S.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha relativisht e re
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 5 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 5 vjet e 6 muaj.

E.M.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.
- Marrja pjesë në sulmin terrorist ndaj policisë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 28 qershor dhe 7 tetor 2012

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 6 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 6 vjet e 6 muaj.

A.Z.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha relativisht e re

- Nuk ka dosje të mëparshme penale

Rrethanat rënduese

- Qasje e tepërt politike dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve
- Mos-respekt ndaj sundimit të ligjit, në kuptim të asaj se ishte i gatshëm të shkatërrojë apo të destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke nisur konflikt ushtarak në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes fillimit të luftës guerile.

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e kryerjes së veprave terroriste është 6 vjet, për akuzën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist 2 vjet dhe dënimi unik prej 6 vjet e 6 muaj.

J.S.

Lidhur me këtë të pandehur, ky trup gjykues mori parasysh si në vijim

Rrethanat lehtësuese

- Mosha e re
- Nuk ka dosje penale të mëparshme

Rrethanat rënduese

- Vendosmëria për të realizuar të ardhura të paligjshme duke shitur armë vdekjeprurëse
- Mos-respekt për jetën e njerëzve duke pasur parasysh se armët mund të përdoren për t'iu shkaktuar dëme të rënda njerëzve dhe për t'i privuar nga jeta,

Pas marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues arriti në përfundim se dënimi proporcional për akuzën e furnizimit dhe shitjes së paautorizuar të armëve është 2 vjet, për akuzën penale të përdorimit të armëve 1 vjet dhe dënimi unik prej 2 vjet e 2 muaj.

Në rastin e të pandehurit J.S. nuk u mor parasysh që dënimi unik të bëhet dënim me kusht. Përfshirja e këtij të pandehuri në sigurimin e organizatës terroriste qartë nënkupton se nëse ai nuk do të vuajë dënimin atëherë qëllimi i dënimit nuk do të arrihet.

Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim

Në rastin e të gjithë të pandehurve, trupi gjykues vendosi të llogarisë kohën e kaluar në paraburgim dhe të përfshijë atë në masën e dënimit. Dispozita ligjore lidhur me këtë është në linjë me nenin 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPPK.

Shpenzimet e procedurës penale

I pandehuri do të lirohet nga obligimi për të paguar shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 453 paragrafi 4 i KPPK. Trupi gjykues mori parasysh se ata duhet të vuajnë dënimet prandaj gjetja e parave shtesë për të mbuluar shpenzimet e procedurës penale do të ishte shumë e vështirë dhe në fund do të duhej të mbulohej nga familjet e tyre.

Arkadiusz Sedek

Kryetari i Trupit Gjykes i EULEX-it

Tobias Lapke

Procesmbajtës, Zyrtar ligjor i EULEX-it

Mjeti Ligjor: Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Gjilan/Gnjilane brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të kopjes së aktgjykimit, sipas Nenit 380 (1) i KPPK-së.